

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XVII i botimit, nr. 203, Shtator 2020

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

MARTIN CAMAJ me punën e tij ka vlerësuar veten

Mirënjohja e respekti është nga më pa shpenzimet, por është nga më të vlefshmet. Tu jeshë mirënjohës njerëzve, veprimtarëve, brezave, të cilët kanë punuar, punojnë dhe kanë rezultate është jo vetëm humane por është detyrë dhe domosdoshmëri që u takon brezave, historisë. Ne se ndodhë e kundërta atëherë historia mvishet me mjergull, e mbulon pluhuri, ndryshket, dhe harrohet. Një gjë e tillë është shumë e dëmshme për brezat që vinë.

Më vjen jashtëzakonisht mirë që isha dhe jam pjesë e atyre që për Martin Camajn, por edhe ... **2**



Ndahet nga jeta doktoresha Zylia Kraja

Kirurgu i njohur, Arben Beqiri ka reaguar për ndarjen nga jeta të koleges nga Shkodra, Zylia Kraja, e cila ka humbur betejën me koronavirusin.

Në një shënim në rrjetet sociale, Arben Beqiri thekson se Zylia Kraja bënte pjesë të drejtuesit e

rëndësishme të kirurgjisë, të cilët kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm.

"Zylia Kraja, një emër, që më ka përcjellë që kur kam qene student ne mjekësi dhe shkoja pas Dr. Ali Spahise për praktike ne Spitalin Jorgji Karamitri" ... son ai. **8**

Krenari për origjinën

Kam pas fatin e mirë të jem e pranishme në ceremoninë e dorëzimit të titullit "Dukagjini Nderi i Kombit", me 23 Mars 2017 nga presidenti Bujar Nishani. Do të bëj gjithë jetën ndjenjën e të qenurit krenare që më kishte pushtua gjatë fjalimit që bëri Presidenti për historinë dhe vlerat e Dukagjinit, të cilin ai po e nderonte. **3**

PANAIRI AGRO KULTUROR "SHOSHI-2020"

Ne kuadër të promovimit të vlerave agro kulturore turistike që organizon Bashkia Shkodër në njësit administrative të saj këtë vit aktivitetet u zhvillua në Njësisë Administrative Shosh dhe pikërisht në oazën më të frekuentua malorë të Alpeve shqiptare, atje virgjëria e kulluar hidrike puthet me relievin e egër në hije të legjendave e historive të vjetra. Është fjala vendin e quajtur Va Blini poshtë Gurit Lekes (krahinon pellgu gjeografik i krahinës së Shoshit) që mediatikisht në kundërshtim me topografinë gjeografike, është pagëzuar "Lumi i Shalës"... **5**

PSE EVROPA HEZITON TË NA PRANOJË NË GJIRIN E SAJ?!

Para disa vitesh, kur dëshirës së shqiptarëve për t'iu bashkuar BE-s, kjo e fundit u përgjigj me një qëndrim skeptik dhe dyshues, (dyshim e skepticizëm që po vijon edhe sot), intelektualët tanë të shumë fushave, hapën një debat të zjarrtë, për identitetin nacional të popullit tonë. Në qendër të këtij debati, u vendosën... **11**

"ARTI ËSHTË E VETMJA G JUHË E PËRBASHKËT QË LIDH E I BASHKON TË G JITHË POPUJT E BOTËS"

(Besnik GJONBRATAJ bashkëbisedoi me piktorin kallaratas Fatos Ribaj, në Itali)

Piktori, Fatos Caush Ribaj, me origjinë nga Kallarati, u lind në Vlorë më 25 shkurt 1969 dhe aktualisht prej gati 30 vjetësh, si shumë shqiptarë, jeton në Itali. Fëmijërinë dhe periudhën e adoleshencës i kaloi në Berat, pasi i ati ishte ushtarak. Pasioni ndaj pikturës bëri që të kryejë shkollën e mesme në Liceun Artistik në Berat dhe mandej Institutin e Lartë të Arteve në Tiranë, dega Pikturë, të cilën për shkak të lëvizjes demokratike të studentëve në vitet 90-të nuk e përfundoi, por emigroi në Itali, jo për arsye ekonomike, por siç shprehet vetë Fatosi, "Për të vetmin motiv që ishte dëshira e lirisë dhe e demokracisë e idealeve që në atë kohë mungonin". Në Itali për një periudhë të vogël kohe kreu punë nga më të ndryshmet e të vështirat, derisa ra në kontakt me artistë e piktorë italianë e filloi të ushtrojë profesionin e ëndërruar të piktorit. Fatosi tregon se piktura e parë publike e tij, e cila i dha një shtysë e fortë për të vijuar profesionin e piktorit, ishte ajo e gjyshes së tij, Pajame Ribaj, paraqitur për konkurim në Institutin e Lartë të Arteve, e cila u vlerësua shumë për nivelin e lartë artistik.

Ndër stilet më të preferuara të pikturës për të janë: portreti, peizazhi dhe kolumnat, por kohët e fundit ka filluar të eksperimentojë ... **6**

MARTIN CAMAJ me punën e tij ka vlerësuar veten

Mirënjohja e respekti është nga më pa shpenzimet, por është nga më të vlefshmet. Tu jeshë mirënjohës njerëzve, veprimtarëve, brezave, të cilët kanë punuar, punojnë dhe kanë rezultate është jo vetëm humane por është detyrë dhe domosdoshmëri që u takon brezave, historisë. Ne se ndodhë e kundërta atëherë historia mvishet me mjergull, e mbulon pluhuri, ndryshket, dhe harrohet. Një gjë e tillë është shumë e dëmshme për brezat që vinë.

Më vjen jashtëzakonisht mirë që isha dhe jam pjesë e atyre që bënë për Martin Camajn, por edhe për shumë të tjerë, atë që nuk e ka bërë asnjë njeri, institucion apo organizatë. Dhe nuk më vjen aspak keq për mungesën e modestisë, sepse nga njëherë, dhe në kohën tonë shumë herë, po nuk fole për vete nuk flet askush për ty. Dhe kjo është Shoqata Atdhetare Dukagjini me qendër në Shkodër por me dashamirë, bakëpunorë e mbështetës në Europë, Amerikë e Australi.

Në ditët e fundit të gushtit u organizua një ceremoni që dikush e quajti përvjetori datëlindjes, dikush tjetër e quajti ceremoni e hapjes së dosjes së Martin Camajt. Si njëra si tjetra kanë të bëjnë me jetën e intelektualit Martin Camaj. Kryeministri i vendit, nepërmes një fjalimi e mbrojti fuqimisht Martin Camajn nga "askushi që don të bëhet dikushi", dhe mirë bëri.

Ndërtimi i tavolinës është shumë i rëndësishëm për ata që marrin pjesë aty, por edhe më gjerë. Të ndërtosh një tavolinë, dhe këtu nuk është fjala vetëm për të ngrënë, sepse edhe ajo duhet organizuar me kujdes, por, këtu, është fjala, në radhë të parë, për biseda apo kuvende, ku "ndëshen burrat, siç thuej motit, gju për gju". Ka shumë rëndësi se kë ke përballë, si organizohet takimi, mbledhja, konferenca, kuvendi, sepse çdo kuvend edhe në të kaluarën por edhe sot mund të mos arrijë qëllimin për faj të organizatorëve, për faj të pjesëmarrësve, ose të dyjave bashkë, por kjo e fundit shumë më radhë. Pra ndërtimi i tavolinës, kuvendit, tubimit, nuk është një punë krejt e lehtë, madje ka rëndësi që duhet ta dinë dhe vlerësojnë organizatorët, ata që bëjnë rregullat protokollare të veprimtarisë.

Shoqata Atdhetare Dukagjini, nuk ka shkuar, nuk shkon dhe nuk do të shkojnë, si dhelpa pas dashit, pas askujt, qofshin këta politikan, familjarë apo të afërm të atyre që ka punuar për ti nxjerrë sa më në dritë dhe u ka bërë vend në shoqëri dhe histori. Ajo nuk do lavde pompoze, por një vend sa për të marrë pjesë i ta-

konte, ndoshta në rreshtat e parë, edhe për faktin se djemtë e Gjellave të The-thit, atë dhe grupin e tyre i strehuan, i mbrojtën, i ushqyen, dhe i përcollën, bashkë me grupin ku bënte pjesë Martini dhe i drejtuan për andej nga kishin drejtimin dhe shkuan pa u hy ferra në

për pikpamjet e tij, e kishte të pamundur jetesën brenda vendit, shërbyen për organizimin apo pjesëmarrjen në veprimtaritë shkencore për Martin Camajn.

Martin Camaj ishte mësues në Prekal në vitet e para pas çlirimit. Ne




këmbë, por ata që i përcollën e paguan shtrenjt në kohët e mëvonshme.

Në këto momente po flas vetëm për punën e bërë për intelektualin Martin Camaj. Vërtetë ne nuk jemi akademik as profesorë, nuk jemi institucion me fonde e mjete materiale në dispozicion, por me intuitën tonë, me njohuritë që morëm pas vitit nëntëdhjetë, nga disa prej atyre që mbijetuan dhe jetonin pas kalimit të atij grupi përtej kufirit. Materialet që

kemi gjetur në Arkivin e Shtetit dhe kemi fotokopjen e një dokumenti të nënshkruar me dorën e tij, me të cilin informonte drejtuesit e arsimit të Rrethit të Dukagjinit, në atë kohë, në lidhje me disa nxënës që ishin larguar nga shkolla e Prekalit në vjeshtën e vitit 1946, për shkak të moshës së madhe. Dokumenti mban datën 8.1.1947 firmosur me dorën e tij si mësues.

Kjo shoqatë jo fitimprurëse, është mbështetur në lidhjet e forta ka pa-



Pamje nga Rragami i Shalës

u mblodhën në popull, në shtypin e kohës, dëshmitë e bashkëudhëtarëve në rrugëtimin e tyre për të dalë jashtë kufijëve të Shqipërisë, pasi atë formë regjimi që u instalua në Shqipëri dhe

sur dhe ka me bijët dhe bijat dukagjinase, dhe më gjerë, që janë larguar dhe janë vendosur jashtë Atdheut. Nga kursimet e tyre, ata kanë ndihmuar dhe ndihmojnë në veprimtarinë e

Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", dhe për të cilët jemi kryelartë. Natyrisht mbështetja kryesore është dhe mbetet te anëtarët dhe dashamirësit e shoqatës në Shqipëri.

Kjo shoqatë ka qenë organizatore, bashkëorganizatore dhe pjesëmarrëse në disa sesione shkencore për jetën dhe veprën e Martin Camajt, ka qenë nismëtare për vendosjen e pllakës përkujtimore në shtëpinë ku është lindur Martin Camaj, në fshatin e tij Temal.

A e di Qeveria dhe zoti Rama, Ministria e Arsimit, Ministria e Kulturës, etj, se në qendër të Shkodrës, aty ku është institucioni më i rëndësishëm arsimor dhe kulturor i Shqipërisë së veriut se Martin Camaj ka një shtatore në bronx, dhe a e dinë se kush ka paguar të gjitha shpenzimet që ishin jo të vogla për një shoqatë si SHAD, e dinë se kush ishte nismëtar në dekorimin me titullin e lartë "Nderi I Kombit" të Martin Camaj, a e dinë se Shoqata Atdhetare "Dukagjini" ka vënë një medaljon me emrin e Martin Camajt dhe që jepet për veprimtari arsimor, kulturor e artistike të daluarve në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi, etj. Kjo, pra, është Shoqata Atdhetare Dukagjini, dhe që nuk resht së punuari. U ndala te Martin Camaj, por janë edhe shumë e shumë arritje të tjera, veprimtari, e vlerësime të vlefshme dhe të rëndësishme.

Si nuk i dërgohet ftesë kësaj shoqate, për të marrë pjesë në përvjetorin e datëlindjes së tij, a nuk kishte një vend të paktën për një person nga SHAD, madje edhe mund ti jepej fjala për të përshëndetur, të paktën dy minuta, për asgjë më shumë, vetëm e vetëm se e meriton me punën e saj, mund të ftohej edhe i vetmi person që është gjallë sot nga të gjitha ata që kaluan kufirin në atë rast, bashkëudhëtarja që kaloi kufirin bashkë me ata në ato ditë të vështira dhe shumë të rrezikshme të vitit 1948, përmes Alpeve Shqiptare, Prenda Mark Shpendi, e pse jo edhe djali i vetëm i gjallë i Ndre Cufës i cili jeton. Ndre Cufa ishte ai që së bashku me kushrinjtë e tij në Rragam të Shalës i strehoi, i ushqeu, i mbrojti për disa ditë, dhe i përcolli duke vënë qafën e vet në gërshërë, vetëm për besë, ide, nder e burri. Kushdo që ka shkruar apo shkruan për ato ditë dhe atë kohë, mbas vitit nëntëdhjetë e ka pasur dhe e ka mundësinë, që të kujtojë ata që bënë më të mirën e mundshme në kushte ekstremisht të rrezikshme, ashtu siç kujton Prenda Shpendi. Gjithkush duhet ta dinë se kush nuk vlerëson të tjerët nuk do të vlerësohet nga të tjerët.

Martin Camaj ka vlerësuar veten me punën e tij, dhe ne kemi për detyrë që të njohim dhe vlerësojmë punën e tij.

Luigj SHYTI

Krenari për origjinën

Kam pas fatin e mirë të jem e pranishme në ceremoninë e dorëzimit të titullit “Dukagjini Nderi I Kombit”, me 23 Mars 2017 nga presidenti Bujar Nishani. Do ta kujtoj gjithë jetën ndjenjën e të qenurit krenare që më kishte pushtua gjatë fjalimit që mbajti Presidenti për historinë dhe vlerat e Dukagjinit, të cilin ai po e nderonte.

Që e vogël jam ndjerë krenare për origjinën time nga Dukagjini dhe prindërit na kanë ushqyer me këtë ndjenjë, duke na folur vazhdimisht për origjinën e tyre. Jam nxënëse e Shkollës “Martin Camaj” dhe sa herë kaloj pranë portretit të tij në hollin e shkollës, ndjej se aty kam një thesar që më bën të ndjehem mirë.

Kam dalë disa herë deri në Prekal,

tjera. Po udhëtoja me Tezën Rozë dhe Profesor Aleksin, të cilët më tregonin për vendet nëpër të cilat po udhëtonim. Kur mbërritën në Thanë, tek Leka, daja i nënës time, gjëja e parë që më ka befasuar ishte mikpritja. E kam ndier vetën sikur të kisha jetuar shumë kohë më përpara. Shtëpinë e njihja nga tregimet e mëmës dhe fotot. Por sado që të dëgjosh dhe shikosh në video apo foto kurrë nuk arin të ndjesh kënaqësinë e të qenurit aty. Çdo gjë ishte e bukur dhe e mirë. Më ka bërë shumë përshtypje punimit e gurit të cokat, me një mjeshtri të radhe formonin shkalla dhe mure shumë simetrike.

Pas drekës unë kisha menduar se do i bëja një dy orë gjumë të mira. Por kjo nuk ndodhi. Ne u nisëm për tek shpella në afër-

e bjeshkës të krijonin përshtypjen e të qenurit në një amfiteatër madhështor.

U nisën për në Ballshkja, bjeshka kur dikur banorët e këtij fshati qëndronin gjatë verës me bagëtinë e tyre. Pas dy orësh mbërritëm në Ballshkja, ku çetinat shekullorë qëndronin përball nesh duke na uruar mirë se ardhjen tre brezave.

Profesor Aleksin, më i moshuari dhe Andrea 8 vjeç i cili pasi ka udhëtuar disa herë na tregonte rrugën pa ngatërruar atë çfarë Leka i kishte mësuar më përpara. Pa afrohej mesdita dhe buka që e kishim mbajtur në shpinë, në flladin e bjeshkës ishte shumë e shijshme. Nga aty, ne shikonim Shalën, Shoshin, Pukën, Ducajt e shumë vende. Të shtrije krahët të dukej se njërin e mbështesje në Bigën e Gimajve dhe tjetrin në majën e Hekurave. Në qafen e Bllshkjaut qëndronte prej disa shekujsh çetina në formën e drerit, e cila ishte shtri rehatshëm, në token e saj dhe kundronte bjeshkën një pamje përrallore.

Zbritja në shpellën e Borës ishte e frikshme, por aty qiellin ta kufizonte gryka e shpellës dhe aty ndodhesha në frigoriferin natyror. Boronica dhe luleshtrydhet ishin frutat e pyllit. Dita e nesërme solli me vete befasinë e parë.

U zgjova pa dhimbje muskujsh pas gjithë asaj ecje.

Vizituam disa Shtëpia fatkeqësisht të braktisura dhe disa të rrënuara. Secila mbarte mbi vete histori, që ndoshta shumë shpejt do shuhej nga braktisja. Pranë kishës ndodhej ujëvara e bukur. Gurra e Thanit formohej nga tri burime, që dilnin shumë afër njëra-tjetrës dhe uji ishte i kulluar dhe shumë i ftoftë.

Tek del Kiri ishte një mrekulli, uji dilte nga toka në atë mënyrë që të krijohej përshtypja sikur Zoti ja kishte bërë dhuratë ndonjë çobani, sikur e ka pa të etur pas një ecje të lodhmë. Ishte pamje magjepse.

Të dashur lexues, ju mund më thoni se kjo mahnitje e imja nga bukurit e këtij vendi pak si të ekzagjeruar. Po mund të ju them provojeni e do jemi në një mendje. Këtu në Plan çdo gjë Zoti e ka krijuar mirë dhe bukur.

Tani me rrugën e re besoj se shumë

Punëtorët duke punuar në rrugën e Thanit



Shpella e Thanit

shpejt banorët e këtij fshati do të rikthehen të paktën për sezonin verorë dhe kjo do ta gjallëroj jetën përsëri.

Përgatitur nga Elsona Aramalli



Ujëvara e Thanit



Çetina e Alpeve

si të ish shkollës. Ishte hera e parë që hyja në një shpellë. Kemi ecur shumë gjatë në thellësinë e saj, ku Daja Leka na printe. Ndalua shumë herë, se vërtet, edhe për Profesor Aleksin, icili ka vizituar shumë shpella kishte shumë gjëra të veçanta nga shpellat e tjera. Diçka e veçantë ishte, se aty nga prania e rrjedhjes së ujit kishte ajër dhe freski. Stalaktitet dhe stalagmitet ishin të shumë llojshme dhe kërkonit të fokusoheshin në foto, por ishte e pamundur se ato ishin të panumërta.

Në mëngjes, Brilanti djali i dajës Lek, na përcolli me makinë deri Ndërfusha (kjo rrugë ishte e sapo përfunduar me iniciativën dhe kontributin e lagjes së Thanit). Ato lëndina të mbështjell me majat

Tek stani në Bjeshkë



KONAKUN E KISHA T'SIGURT

Kam dro se librat s'kan me mi dashtë, shkodorant!

Kur mbrina n'Shkodër, konakun e kisha t'sigurt. Thashë i librave ishte Filip Shiroka, e s'idhnohet kur t'i nxjerri dengat me librat e mi!

Dorkun e lidha n'oborr, e Gjon Dukgilës i thirra: A t'ka marrë malli për Kerin e Vogël?

Qe ku e ke, pa plis, pa shall, pa tirq!

Krejt i ka vjerrë çetinave t'Stancakajve, tue u ngut mos me zanë nata Karadakut!

Dil rehatoja atin, se e ka lanë Rugovën për Rozafën!

E ka ba njet me ia veshë kmishën me via t'arrës, se fort po e kqyrin ustallarët kah po i jep djalit gji! U batë përrallë tue lanë që peqind vjet cullak n'gur t'Kalasë!

- Kujt po i flet o mixhok, ma ktheu një çikë shkodorane me shokën e kuqe n'ije, që rrinte brenda n'kullën e Filipit. Ky asht hotel Tradita, e Gjoni asht sonte n'Shalë, por ti bujrum, se jemi ne, bijat e Shkodrës që t'bamë konak!

U knaqa kur m'folen n'g'juhën e nanës Sheke, sa s'prita dy herë me m'thanë, hajde mirë se ke ardhë!

Po, kjo asht shtëpia e Filip Shirokës, bile dhomën e vet e ka t'pa prekun. Mundësh veç derën me çelë e me sy me kullotë! Jo ma shumë!

Gjoni paska dalë n'Shalë, thashë, se s'i rrihet n'rtrash. Iriqi don therra e Gjoni thepa!

Mbasi u rehatova, i mora tre libra e zbrita deri të Isa Begu, se m'u duk i mërztishëm, e thashë t'ia lexoj një poezi për Zhazhën!

Mandej dola n'çarrshinë e vjetër e tri herë e shkela, se mu duk vetja si Isa Begu. Besa dy herë edhe bërtita tue xhirua vetvetën: Ç'tu desht me lëshua Shkodrën e me dalë n'Podgoricë Isa Beg! A pak t'mashtroi shkjaun n'Boletin, kur e maroi kishën n'tokën tande?!

Nji djalosh, me emnin Armando Dermani, që pinte kafe, rrehi shuplaka. E meritove kafën plak m'tha!

Paj pasha t'lumin Zot po, me ditë se m'lsho' zemra, pa e pi me ty s'e la!

Dhe u ula n'tavolinën e tij!

Kur e muer vesh kush jam, edhe nji herë ma shumë u gëzua!

A ti artisti që shet libra je a?

Po more i thashë. Erdha edhe te ju. Veç ishalla s'e koritni Malsinë ju shkodorant, me thanë kemi dalë për peshkim, se asht dro me i gjujtë te tana n'liqe e me iu thanë: mbushni rrjetat. Sa shumë qeshem!

Qenke edhe hokatar ti, jo veç artist!

O gjithëka jam veç poet e shkrimtar jo!

E pse po shkruen libra pra?

Po shkruaj se po shkruen gjithkush. Po knoj se po knon gjithkush. Gjithkush asht ba i mençëm e po sundon. E pse mos me i sundua unë shkarravinat e mia.

O pasha lahutën e babës krejt çarshia e muer vesh se nji plak budallë nesër ka me kjenë me libra n'Pedonale!

Njeni nga Prizreni, që ishte n'Velipojë me pushime, m'u afrua e m'tha ma nënsh-

kruej ket libër bastardësh.

Mos i thashë se asht shtrejt, e të duhen paret për det!

Nji ditë ma pak asht nji libër ma shumë m'tha kur e pagoi!

Mbramë luate Shqipnia me Lituaninë futboll. E shikova pak, por m'kishte pasë marrë gjumi, e veç kur u çova me hangër mëngjes i ndëgjiova do tifoz tue sha! Kishte humbë si Kosova!

Pasha jetën e sosun, mbramë knoi gjeli bashë kur hoxha e thirri ezanin, e mua m'shkoi mendja të gjeli i babës. More Zot thashë, bash si n'tregimin tim, edhe ky i kallxoi hoxhës kur duhet me falë sabahin, si ai gjeli i babës tem!

E kqyra orën, kishte qenë tue u ba pesë!

M'kishte pasë marrë edhe njiherë gjumi, por prap gjeli m'çoi. More perendi thashë, a mos e paskan pasë mble shkodorant at gjelin që e shiti nana n'Pejë, për pantallonat e mia!

S'fjeta ma.

Dola n'oborr me pi kafe.

Tash po ia zgjidhi kërpeshin kalit tim, e po dal n'pazar me shitë libra, sa s'kanë



shkua shkodorant n'liqe me n'xanë peshk!

Sa e mirë je moj Shkodërloce, po qyshë s'ma rrejte Ndreke Lucën e Rikard Ljarjen. A e din sa herë Fishën ma kan pru n'zemër!

Kam dro se librat s'kan me m'i dasht.

A dini pse?

S'i duen fort t'njoma këta, e hala s'janë tha taman!

Shnosh, se Buna s'dvetë, n'det t'i çon, ndaç n'Velipojë n'daç n'Ulqin, e rrezitën bashkë me kosovarët!

Çun Lajçi
Shkodër, Hotel Tradita
08.09.2020
fb

Vartësia është skllavërim dhe vuajtje

Vartësia fizike fillon menjherë me lindjen e njeriut. I porsalinduri është plotësisht i varur nga nëna dhe babai, për gjërat më jetike, ushqimin dhe mbrojtjen nga të ftohtit. Kjo vartësi fizike, shndërrohet shumë shpejt në ndjenjë tek fëmia, dhe ai proteston me ë qarë, nëse nuk i merr në kohë. Madje edhe ndërrimin e pelenave. Duhet njëfarë kohe derisa merr një send dhe e futë në gojë. Zhvillimi motorik ia mundëson avash kordinimin e lëvizjeve, është faza që neuronet njihen me njëri-tjetrin, lidhen dhe bashkëpunojnë, bashkëpunim ky që mbetet për gjithë jetën.

Fëmia, vazhdimisht, mundohet që të bëhet sa më i pavarur. Provon të ngrihet, të ecë, dhe të ushqehet vetë, pa ndihmën e prindërve. Vjen momenti, që ndihma, nga nevojë, i bëhet besdi, e bën të ndiehet keq. Veçanërisht kjo, në moshën e pubertetit, kur fëmia fillon të takohet me moshatrët e vet.

Kjo nuk do të thotë se mori fund faza e vartësisë. Vetëm është ndërruar lloji i vartësisë, nga vartësia prindërore, në atë të grupit.

Antarët e grupit, vishen në një mënyrë tjetër, natyrisht ndryshej nga të rriturit. Ata takohen në vende të përzgjedhura prej tyre, dëgjojnë të njëjtën muzikë, janë shumë të përafërt me njëri-tjetrin për mënyrën e vlerësimit dhe perceptimit të mjedisit.

Grupet ndërtojnë kodet dhe ritualet e tyre të sjelljes dhe komunikimit, me njëri-tjetrin dhe mjedisin.

Kjo do të thotë se të rinjtë, janë në kërkim të identitetit të tyre. Ata mendojnë se, sa më shumë që largohen nga vartësia e prindërve, aq më shpejt do t'a arrinë identitetin e tyre.

Kjo mënyrë të menduari, nuk do të thotë shumë, pasi ata, vazhdimisht kalojnë nga njëra vartësi tek tjetra, nga ajo prindërore në atë të grupit, shoqërisë, jashtë familjes.

Një dukuri e tillë, është karakteristike jo vetëm për të rinjtë, por edhe për të rriturit. Të sëmurët dhe të moshuarët, janë në vartësi të përkujdesjes nga dikush tjetër.

Jo çdo vartësi është e dhimshme dhe fatkeqe.

Lypësi është në vartësi të bujarve, për kafshatën e gojës. Alkoholisti është i varur nga alkoholi. Drogëkonsumuesi vështë i varur nga droga. Të gjitha këto vartësi mendohen të nevojshme, në një kohë të caktuar.

Njeriu, me ose pa dashje, mund të jetë i varur edhe nga shumë gjëra të tjera, nga pushteti, nga paraja, nga dhuna.

Njeriu varet jo vetëm fizikisht dhe materialisht nga tjetri, por edhe psikologjisht. Në rastin e vartësisë psikologjike, njeriu nuk është më vetëvetja, është dikush tjetër. Në shumë raste, as ai vetë, nuk e din se kush është.

Nga mënyra e të sjellurit, shumë të rritur, tregojnë se jetojnë në vartësi të të tjerëve, ose të diçkaje. Ka njerëz të cilët e ndiejnë veten aq të humbur, dhe të pazot, sa nuk guxojnë të jetojnë të pavarur, për asnjë rast. Ata gjithmonë kërkojnë një „mburojë“.

Gjithandej ka njerëz që u bëjnë thirrje të paafteve, të humburve, që të bashkohen rreth tyre, duke u premtuar, se do tua dhurojnë një identitet të veçantë. Një gjë e tillë më tipike është tek sektet.

Ka sekte të ndryshëm, në religjion, politikë, sport, jetën sociale, dhe njëkohësisht të njejtë nga qëllimi. Ata mbajnë miliona njerëz në gjëndje vartësie, të cilëve u japin ndjenjën e gjetjes së identitetit të vet. Sektet janë grupime dhune, intolerance. Pjestarët e grupimeve, nuk guxojnë ta shfrytëzojnë inteligjencën e tyre. Nuk kanë asgjë për të thënë, duhet vetëm të binden. Ata jetojnë në vartësinë që u dikton padronit i tyre, asgjë tjetër nuk mund të bëjnë. Manipulimi i tyre nuk mbaron kurrë. Ai vazhdon deri në fazën e fanatizmit total.

Fanatikët, fare thjeshtë, mund të shndërrohen në terroristë. Në individë dhe grupe që gjenerojnë vetëm dhunë. Veprimtaria e tyre e dhunshme, mund të shfaqet kudo dhe në çdo kohë.

Dhuna fillon në familje, shkollë, vazhdon në stadione sportive, me përleshje midis grupeve të tifozëve, me gjuajtje me sende të forta të arbitrave, ekipit kundërshtar në fushë, dhe vështirë se ndalet.

Demonstratat, shpesh janë vendi ku, të ashtuquajturit gangsterë, shfaqin pikën kulmore të dhunës, ndaj policisë, kundështarve politikë, dhe objekteve.

Militantët e grupeve terroriste, vëndosin bomba sipas urdhërave të padronëve të tyre, për të vrarë njerëz të pafajshëm. U vënë zjarrin makinave apo objekteve të ndryshme. Kryejnë vrasje me porosi apo thjeshtë për terror.

Shumë prej tyre i kryejnë aktet e dhunshme apo terroriste, për të treguar basnikëri dhe nënshtrimin e plottë, ndaj grupit ku ata bëjnë pjesë, apo padronit të tyre.

Njerëzit e varur janë njerëz të pushtuar, njerëz që e kanë humbur vetëveten.

Fanatikët i rekrutojnë njerëzit nga të gjitha shtresat e shoqërisë. Ata jetojnë në një burg shumë solid, nga i cili mund të dilet shumë vështirë. Ndoshta kurrë.

Lekë Imeraj
shkrimtar, përkthyes, publicist

PANAIRI AGRO KULTUROR “SHOSHI-2020”

-Va Blini Guri i Lekes -

Ne kuadër të promovimit të vlerave agro kulturore turistike që organizon Bashkia Shkodër në njësit administrative të saj këtë vit aktivitetet u zhvilluan në Njësisë Administrative Shosh dhe pikërisht në oazën më të frekuentua malorë të Alpeve shqiptare, atje virgjëria e kulluar hidrike uthet me relievin e egër në hije të legjendave e historive të vjetra. Është fjala vendin e quajtur Va Blini poshtë Gurit Lekes (ku fillon pellgu gjeografik i krahinës së Shoshit) që mediatikisht në kundërshtim me toponiminë gjeografike, është pagëzuar “Lumi i Shalës”

Me datën 14 gusht 2020, Bashkia Shkodër, në bashkëpunim me organizatën “Green Center Albania” organizuan këtë udhëtim mbresëlënës drejt Va Blinit dhe Gurit të Lekes.

Krahas një panairit të pasur me produkte dhe karakteristike të zonës u zhvillua edhe një program artistik nga grup folklorik “BESA Shosh”.

Ftesën e Kryetarit Njësisë Administrative Shosh, z. Ndoc Ashta, e mirëpriti dhe grupi ynë e i dha larmi kësaj ditë të veçantë shoshiane, në gjirin e strukur të një bukurie dehëse të mbipopulluar nga pushues nga Evropa dhe shumë trevat shqiptare.

Deri në Koman udhëtuan me një autobus komod mbi një trase të shëmtuar të pa venë dorë që nga koha e nderimit të veprës më të madhe energjetike të kohës enveriane. Nga diga e HC të Komanit në Va Blini, udhëtimi ishte si në përralla përgjatë një hullie të kaltër gjithë fllad nën sitën e rezeve të arta të dellit sy gacë të gushtit. Për gjatë liqenit të qetë dhe me pas duke menduar në degëzimit kristalin Lesniqës Nenplepit dhe Blinit, këngëtarët e grupit “Besa”, Ndoc Fusha, Kolë Gjoni, Gjëlosh Fusha, Gegë Zefi, Gjergj Temeli, të cilët kënduan këngët të ndryshme, me tematike epike dhe lirike të shoqëruar edhe nga kori i mbi tridhjetë të rinjve e të rejave, që udhëtonim në dy varka paralel njëra me tjetrën dhe të fiksuara në celuloid nga Kamerat e TV1 Channel.

Pas tre orësh arritëm dhe u morëm gryke Va Blinit, që duket se Zoti e ka zbritur nga qielli për ne, por fatkeqësisht nuk ja dimë ende të mirën. Ishte dite jave, e premtë dhe u befasuam nga numri i madh i vizitoreve kryesisht të moshave të reja, të cilët të gëzuar dhe të qeshur sa me s’ka, se donin të shijonin gjithë nga

perla e hijshme.

Ne, u vendosem në një ambient të jashtëm të lokaleve, në këtë hapësirë, të përgatitur enkas për këtë veprimtari.

Në këtë ambienti ishte vendosur një banderole, një mozaik koloristik nga natyra e Shoshit, me stemën e Bashkisë Shkodër.

Veprimtarinë e hapi i zoti i shtëpisë, Ndoc Ashta, i cili falënderoi pjesëmarrësit dhe foli për pasuritë dhe vlerat kulturore e turistike të pa eksploruara, që ka krahina



e Shoshit, me Gurin e Lekes. Gjithashtu shprehu shqetësimin për mbështetjen e pakt, që i bëhet për infrastrukturën, si domosdoshmëri për zhvillimin e këtyre krahinave, duke i kërkuar vëmendje e institucioneve të larta, që të paktën të hapej një rrugë automobilistike nga Blini- Pepsuj- Ndrejaj, e cila pastaj kjo lidhet me rrugën kryesore Shkodër-Breg Lumi-Theth.

Drejtoresha e “Green Center Albania”, znj. Anila Neziri, bashkë organizatorja e kësaj veprimtarie, e çuditi gjithë kjo bukurie e pa pame, nuk nguroj ta krahasonte me vendet me ekzotike të Amerikës. Latine

I treti e mori fjalën Profesor As Dr. Zef. Gjeta, biri i kësaj krahine, ku bujtinat dhe mjediset e ngritura këtu, janë në pronën e tij, ndërtuar nga vëllezërit dhe nipat e tij. Ai uroj mirëseardhjen e pjesëmarrësve dhe tregoj në mënyrë shkencore, se çfarë vlere ka bimësia e kësaj krahine, veçanërisht bimët mjekësore, i cili edhe shoqëroj pjesëmarrësit në trojet e tij dhe ekspozoi punën që po bën në gjallërimin e këtyre bimëve

Në fund e mori fjalën biri i Shoshit, shkrimtari dhe publicisti Prele Mark Mi-

lani, në cilësinë e Sekretarit të shoqërisë kulturore artistike “BESA Shosh”, i cili pasqyroj punën dy vjeçare të kësaj shoqërie. Ai, theksoi, se jam i privilegjuar që jam pjesëtarë i këtij grupi të mrekullueshëm folklorik, i cili ka vetëm dy vjet veprimtari dhe është vlerësuar në tre festivale folklorike mbarë nacionale, dy herë i është dhënë çmimi i dytë dhe një herë i është dhënë çmim të parë, të versuara nga juri me përbërje nga gjitha trojet Shqiptare. Milani beri thirrje për më shumë

veprimtari të tilla, pasi këto mbajnë gjalle traditën tonë të mikpritjes dhe të këngës. Ky resorituristik duhet të kushtojë rendësi edhe prezantimit të kujtesës historikë që lidhet me Gurin e Lekës, dhe vatanit të heroit epik, Sokol Tona, i trimit të paepur Ndoc Deda, martirit të pavarësisë Bush Delia, gurit të themelit të babait të muzikës popullore shkodrane, Kolë Gurashit. Duhet etiketuar dhe njohur e fortesës natyrore e Komlemit, ku Shoshi mbrojti identitetin e vet kristian nga sulmet e çmendura të Begollajve të Pejës, në krye të forcave ushtarake osmane. U Duhet prezantuar vizitorëve toponomina historike. “Curi Topit”, “Ura e Pejës”, “Shkambi i Haxhi Begut”, vrasja e Ndre Buxhes, që ilustronjë më së miri këtë qëndresë.

Këtu ka disa bujtina dhe shesh pushimi, për relaksim. Këtu është vend ideal për koncerte dhe festivale nga mbare trevat shqiptare, prandaj duhet filluar një nismë, që behet tradite e përvihtshme. Në fund të ligjërimi grupi “BESA Shoshi” paraqiti programin folklorik “Mirë se vini në Shosh!” Programi u çel me këngë maja krahu, kënduar nga Gege Zefi dhe Gjon Kosteri. E dyta ishte lahuta e Kole Gjoni. Prefekt, grupi “Besa Shoshi”, kishte sjellë një këngë enkas për kreshniku nga Guri i Lekes, Sokol Tona, i cili dha jetën në kullën e Vranines, të cilën e interpretuan, Ndoc Fusha, Gjëlosh. Kola e Gjon Kosteri. Kënga meritoj duartrokitje të ngrohta nga te pranishmit

Në fund grupi “BESA Shoshi” këndo



himnin e vet tradicionale “Ku t’ marr Besë e ndore”, kushtuar Besës së Shoshit.

Pasi u mbyll programi zyrtar, të zotet e shtëpisë kishin organizua një panairë, me produkte bujqësore e blegtorale nga krahina e Shoshit, që u pëlqyen shumë nga të pranishmit

Më pas pjesëtarët e manifestimit grupe-grupe vizituan fshatin. Guri i Lekes, shijuan ujin Kristal të lumit, ku demonstruan edhe aftësitë e tyre notuese në këtë lum.

Në fund, Bashkia kishte shtruar një drek për pjesëmarrësit

Gjatë drekës, grupi “BESA-Shoshi” vijoi programin artistik, me këngë e melodi të ndryshme.

Mbas dite vonë, pas një dite me shumë veprimtari të lodhshme, por mjaft të gëzuar dhe me kujtime shumë mbresëlënëse, pjesëmarrësit morën rrugën për në Shkodër.

Kjo dite kulturore dhe material do mbahet mend gjatë, prandaj falënderojmë gjithë ideuesit, organizatorët dhe pjesëmarrësit e kësaj veprimtarie.

Por, në mënyrë të veçantë Gjergj Temelin, pjesëtarin e grupit “BESA Shoshi”, që kishte ardhur enkas nga Italia, ku punon si emigrant.

Gjon Kosteri,

Drejtuesi organizativ i grupit “Besa”.



Gege Zefi, Prele Milani, Ndoc Ashta, Kole Gjoni, Ndue Fusha, Gjon Kosteri, Kole Martini, Gjergj Temeli, Gjëlosh Kola, Ndoc Fusha, Fran Sukani e Nosh Lejthia



Mali i Komlemit

“ARTI ËSHTË E VETMJA G JUHË E PËRBASHKËT QË LIDH E I BASHKON TË GJITHË POPUJT E BOTËS”

(Besnik GJONBRATAJ bashkëbisedoi me piktorin kallaratas Fatos Ribaj, në Itali)



Besnik Gjonbrataj

Piktori, Fatos Caush Ribaj, me origjinë nga Kallarati, u lind në Vlorë më 25 shkurt 1969 dhe aktualisht prej gati 30 vjetësh, si shumë shqiptarë, jeton në Itali. Fëmijërinë dhe periudhën e adoleshencës i kaloi në Berat, pasi i ati ishte ushtarak. Pasioni ndaj pikturës bëri që të kryejë shkollën e mesme në Liceun Artistik në Berat dhe mandej Institutin e Lartë të Arteve në Tiranë, dega Pikturë, të cilën për shkak të lëvizjes demokratike të studentëve në vitet 90-të nuk e përfundoi, por emigroi në Itali, jo për arsye ekonomike, por siç shprehet vetë Fatosi, “Për të vetmin motiv që ishte dëshira e lirisë dhe e demokracisë e idealeve që në atë kohë mungonin”. Në Itali për një periudhë të vogël kohe kreu punë nga më të ndryshmet e të vështirat, derisa ra në kontakt me artistë e piktorë italianë e filloi të ushtrojë profesionin e ëndërruar të piktorit. Fatosi tregon se piktura e parë publike e tij, e cila i dha një shtysë e fortë për të vijuar profesionin e piktorit, ishte ajo e gjyshes së tij, Pajame Ribaj, paraqitur për konkurrim në Institutin e Lartë të Arteve, e cila u vlerësua shumë për nivelin e lartë artistik.

Ndër stilet më të preferuara të pikturës për të janë: portreti, peizazhi dhe kompozicioni, por kohët e fundit ka filluar të eksperimentojë me mjaft sukses pikturën abstrakte, duke mos lenë mënjandë dhe peizazhin.

Ka marrë pjesë në disa ekspozita kolektive e individuale në Itali, Francë dhe Austri, ku ka fituar shumë çmime si: “Raffaello Sazio” në Firenze, “Giorgio Vassari” në Grosseto, “Michelangelo Buonarroti” në Romë, “Cristoforo Colombo” në Genova e shumë çmime të tjera. Pikturat e tij sot ndodhen në galeritë më të njohura të Italisë si: galeria “Orler”, në Venezia, galeria “Malinpena” në Torino dhe galeria “Meringi” në Genova dhe disa prej tyre dhe në Amerikë.

Edhe pse familjarisht i vendosur në Itali, Fatosi nuk e harron kurrë, Kallarat, Vlorën dhe Beratin dhe është i gatshëm të kontribuojë, qoftë me hapjen e një ekspozite personale në Tiranë dhe Vlorë, ndërsa për Kallarat, vendlindjen e të atit, Caushit, që sa ishte gjallë e deshi aq shumë, pikësynimi i tij është të pikturojë “Fshatin e Djegur”, siç ka qenë para djegies nga andardët grekë më 1914, me shtepitë e tij karakteristike e të bukura, të ndërtaura në pllajë, rrëzë Bogonicës.

Për më tepër rreth jetës dhe ushtrimit të profesionit të piktorit të Fatos Ribaj, le të ndjekim intervistën e mëposhtme:

Si u lindi dëshira për t’u bërë piktor

dhe cilat ishin shtysat për këtë zgjedhje?

Dëshira për t’u bërë piktor më tepër ka qenë një prirje nga rethanat që më janë krijuar që në vegjëli, jo se kam trashëguar diçka në këtë drejtim nga prindërit ose të afërmit. Natyra e bukur dhe e ashpër kur shkoja me pushime në vendlindjen e babit në Kallarat, ka ndikuar jo pak, por që u përforcua akoma më shumë në qytetin e Beratit, ku kalova vitet e vegjëlisë dhe të adoleshencës, në qytetin e “njëmijë dritareve” siç quhet. Aty u frymëzova edhe më shumë dhe fillova të bëj vizatimet e para, ashtu thjesht në letër ose më saktë në fletoren e vizatimit të asaj kohe. Vizatimet e para në letër ndikuan pastaj që unë të konkuroja për në shkollën e mesme në Liceun Artistik të Beratit, të cilën e përfundova 1987. Më vonë vijova shkollën e lartë në Institutin e Arteve në Tiranë, dega Pikturë, të cilën edhe pse nuk e përfundova, për shkak të lëvizjeve demokratike të viteve 90-të, mora një formim më të plotë profesional, se të bëhesh piktor e ta meritosh këtë emër nga publiku, duhet një punë më e gjatë.

Cilën konsideron si pikturën e parë të daljes tuaj në publik dhe si e zgjodhët?

Dalja e parë në publik, flas për ekspozitat e para që organizoheshin në shkollë ka qenë një portret i gjyshes time, Pajame Ribaj, një grua labe, një nënë dhe gjyshe shumë e veçantë për mua. Kur ajo vinte te ne në Berat, duke qenë ulur në kolltuk, i bëja shumë vizatime. Gjyshja ishte një nga modelet e mia të preferuara, se ajo rrinte kohë të gjatë e ulur në kolltuk, duke folur me ato fjalët e ngrohta e tepër të ëmbla me pjesëtarët e familjes time dhe unë gjeja mundësinë për ta pikturuar duke skicuuar në letër portretin e saj që me të drejtë do ta quaja portreti i “Nënës Labe”. Portreti i saj u vlerësua si një pikturë e veçantë dhe me nivel të lartë, ajo ishte një pikturë me stil impresionist dhe jo realist. Edhe sot që kanë kaluar shumë vite ndihem shumë i lumtur që realizimi i portretit të gjyshes më dha nxitjen që pasionin tim për pikturë ta vazhdoj më tej. Si gjithëmonë gjyshet për nipërit dhe mbesat mbeten idhuj në jetë.

A mundët në Shqipëri të ushtronit profesionin e piktorit?

Nga Shqipëria kam ikur shpejt, aty nga viti 1991 dhe nuk pata kohë dhe mundësi reale për të ushtruar profesionin e piktorit. Në Liceun Artistik të Beratit dhe në auditoret e Institutit të Lartë të Arteve, unë mora bazat e para të pikturës, të cilat me vajtjen në Itali më ndihmuan jashtëzakonisht që të ushtroj me shumë qejf e pasion profesionin e bukur të piktorit.

Si përfunduat në Itali, shkuat si emi-

grant për arsye ekonomike për të punuar ku mundet, apo si një mundësi për të ushtruar profesionin e piktorit?

Vitet 90-të më gjetën në auditoret e Institutit të Arteve. Ishte koha kur lëvizja

thë vendin tonë.

Si u krijuan për ju mundësitë e ushtrimit të profesionit të piktorit në Itali?

Në Itali kur erdha gjeta një realitet krejt tjetër. Për një emigrant nuk ishte e lehtë. Në fillim u detyrova të bëja punët më të rënda, që nuk më kishin shkuar kurrë ndërmend, por isha i detyruar për të përballur jetesën. Gradualisht me ambientimin me vendin, me rregullat në komunitet, arrita të njihem me artistë dhe njerëz të artit dhe të kulturës italiane, ku fillova të frekuentoja edhe vajtjen në veprimtari të ndryshme në shoqata artistësh. Kjo gjë më ndihmoi që më vonë të më krijohen hapësira të ushtroj profesionin e piktorit për të cilën ëndërroja.

Kë lloj pikturë pëlqeni më shumë dhe pse?

Për artistin, arti nuk njeht kufi për të vetmin motiv, dëshirën për t’u shprehur nëpërmjet tij. Por kam kaluar disa etapa të ndryshme të stileve të pikturës. Më ka pëlqyer shumë portreti, peisazhi dhe kompozicioni. Në Itali fillova të pikturoja peisazhe të ndryshme nga natyra e vendeve ku kalova dhe pjesën më të madhe të jetës time, por këto peizazhe i bëja me një frymë nga vinte prejardhja ime, pra Shqipëria dhe mbresat e kujtimet që më kishin ngelur në mendje e zemër i transmetoja në këto peisazhe. Kohët e fundit po eksperimentoj pikturën abstrakte, duke mos lenë mënjandë dhe peisazhin. Janë faza që piktori kalon në veprimtarinë e tij artistike, për të gjetur vetveten dhe për të krijuar origjinalitetin e tij në fushën e artit.

Duke qenë se aplikoni më shumë pikturën abstrakte, çfarë është piktura abstrakte, cilat janë tiparet kryesore të saj?

Piktura abstrakte është një shprehje artistike si gjithë të tjerat, por me të vetmin ndryshim që ka të bëjë me ndjenjat e brendshme të autorit. Ajo është një improvizim i momentit dhe nëpërmjet saj piktori kërkon të komunikojë me shikuesin pa një ide të qartë vizive, por shumë domethënëse nga ana mendore.

A e pëlqen publiku pikturën abstrakte?

Kjo varet nga publiku. Në përgjithësi piktura abstrakte sot njihet si një art modern që paraqet të sotmen dhe të rinovuarën në shoqërinë tonë, që nxiton sa më shumë për arritur atë që mungon dhe për këtë arti abstrakt është pasojë e frenësisë së jetës së përditshme. Kjo gjë e bën pikturën abstrakte që të pëlqehet nga të gjitha shtresat e shoqërisë.

Çpërfaqëson rryma e Abstraksionizmit dhe si konsiderohej ajo në Shqipëri para



studentore dhe mbarë kombëtare ishte ngritur në këmbë ndaj sistemit komunist. Proceset demokratike sollën mundësinë për të lëvizuar edhe jashtë kufijve të vendit, e cila më parë ishte e pamundur. Ashtu si shumë të rinj shqiptarë edhe unë u nisa drejtë Italisë, jo për arsye ekonomike, por për të vetmin motiv, që ishte dëshira e lirisë dhe e demokracisë, e idealeve që në atë kohë mungonin osë më saktë sa kishin filluar të shfaqeshin në vendin tonë. Fli-tet për kohën kur bëheshin ndryshimet e mëdha politike dhe shoqërore, kur diktatura po zëvendësohej me demokracinë, ishte viti 1991. Nuk kisha probleme ekonomike, ishte një moment epokal për gji-



viteve 90-të dhe sot?

Arti modern abstrakt është një rebelim ndaj artit të mëparshëm figurativ, hedh poshtë të gjitha rregullat akademike të krijuara gjatë gjithë historisë mijra vjeçare të tij dhe për këtë motiv bëhet akoma dhe më tërheqës. Në Shqipëri arti abstrakt ka qenë i panjohur dhe për më tepër i ndaluar. Para viteve 90-të, arti abstrakt konsiderohej si një frymë borgjeze dhe kapitaliste, kurse sot do të thoja që ka hyrë dhe interpretohet nga shumë artistë të njohur shqiptarë si brenda dhe jashtë vendit.

Kush janë përfaqësuesit botëror më në zë të kësaj rryme në të kaluarën dhe sot?

Arti abstrakt ka filluar të shfaqet që në fillim të shekullit 19-të dhe autorët e parë kanë qenë: Jane Vasili Kandisky dhe Zhak Delaunay, të cilët hapën rrugën e pikturës moderne abstrakte.

A ke marrë pjesë në ndonjë ekspozitë në Itali, apo qoftë edhe vend tjetër? Po ndonjë çmim a ke fituar?

Po kam marrë pjesë në shumë ekspozita kolektive në shumë vende të Italisë, Francës dhe Austrisë. Në këto ekspozita kam marrë edhe shumë çmime me emrat e piktorëve të medhenj italianë si: "Raffaello Sazio" në Firence, "Giorgio Vassari" në Grosseto, "Michelangelo Buonarroti" në Romë, "Cristoforo Colombo" në Genova e shumë çmime të tjera. Pikturat e mia sot ndodhen në galeritë më të njohura të Italisë si: galeria "Orler", në Venezia, galeria "Malinpensa" në Torino dhe galeria "Meringi" në Genova dhe disa prej tyre dhe në Amerikë.

A keni mundur të hapni ndonjë ekspozitë vetjake në Itali? Nëse po, si është pritur nga publiku dhe kritika italiane?

Po kam hapur disa ekspozita vetjake në Itali dhe pikturat janë pritur mjaft mirë nga publiku, por edhe nga kritika, që e cila ka shkruajtur edhe në disa revista e gazeta lokale, por edhe nacionale.

A është e vështirë për një të huaj ose më saktë për një shqiptar të konkurojë piktorët vendas Italiane?

Jo aspak e vështirë. Në art nuk eksistojnë fjala i huaj, kush është i talentuar pëlqehet dhe konkuron pa asnjë lloj dallimi. Arti në përgjithësi është e vetmja gjuhë e përbashkët që lidhë e i bashkon të gjithë popujt e botës. Arti nuk njihet dallim race, kombësie, feje dhe ideje.

A janë italianët dashamirës ndaj shqiptarëve, në veçanti për ata që merren me art, siç jeni edhe ju?

Në një vend të huaj mund të ndeshesh me shumë probleme të ndryshme, siç është edhe ai i racizmit, por do të thoja që varet shumë edhe nga individët që ndesh përpara. Italianët janë popull me kulturë dhe në përgjithësi respektojnë Shqipërinë dhe shqiptarët, edhe pse individë të veçantë do të thoja, kanë bërë edhe poshtërsira, ku u ka shkelur këmba. Por një popull me kulturë siç është Italia di të ndajë "shapin nga sheqeri" siç i themi neve në gjuhën popullore. Nuk janë të paktë ata artistë, sportistë, por edhe profesione të tjera siç u evidentuan kohët e fundit mjekët shqiptarë, që kanë patur talent dhe nuk janë parë asnjëherë se janë shqiptarë, pasi talenti e çan vetë rrugën e artit, shkencës, kulturës, sportit dhe për të kanë nevojë të gjithë.

A jeni i pranishëm në mediat italiane?

Po që se ia vlen të evidentohesh për publikun, media vjen e të gjen vetë. Edhe unë jam thirrur në disa media italiane për intervista, ku janë prezantuar me ekspozitat personale osë kolektive qofshin ato. Por për një artist nuk është e rëndësishme dalja në media. Ajo që është më e rëndësishme, është arti i tij osë veprat që ai krijon. Për një artist duhet të flasin veprat se sa ai vetë.

A keni ndonjë shifër të pikturave të tua? Ku ndodhen sot ato?

Nuk dua të krahasohem me artistët e mëdhenj që kanë lënë me të vërtetë kryevepra në krijimtarinë e tyre, por do të tho-



sha që është e rëndësishme vlera që ato kanë dhe më kryesorja sa ato i perballojnë kohës. Kjo është vlera e vërtetë e një veprë arti. Pikturat e mia sot ndodhen në galeritë më të njohura të Italisë si: galeria "Orler", në Venezia, galeria "Malinpensa" në Torino dhe galeria "Meringi" në Genova dhe disa prej tyre dhe në Amerikë.

Përveç kënaqësisë profesionale të marrurit me art, pikturë, a të jep fitim financiar?

Në radhë të parë piktura dhe arti në përgjithësi të jep kënaqësinë shpirtërore, që nuk ta japin eurot dhe dallarët sado shumë qofshin ato. Por megjithatë si çdo punë e profesion tjetër edhe profesioni i piktorit ka të ardhurat e veta financiare, që janë të nevojshme për të jetuar vetë dhe familja. Por do të thoja se, për një artist që trajton tema jo komerciale, për një

artist që dëshiron të pasqyrojë vetveten në art, rruga e artit për të është më e vështirë se sa e dikujt që bën panorama osë që kopjon artistë të tjerë.

Në Itali ka plot shqiptarë, njerëz të sportit, artit e kulturës që kanë bërë emër, po veç jush, a di të ketë ndonjë tjetër piktor të dëgjuar?

Për piktor nuk di të ketë shumë. Këtu ku jetoj unë ka emra të njohur si, piktori i mirënjohur Sali Shijaku. Por piktori që ngre në pedestal emrin e shqiptarit, është emri i Ibrahim Kodrës, një nga piktorët më në zë e të njohur të viteve 50-të, 60-të e 70-të. Ai është piktori më i dëgjuar i të gjitha kohërave në Itali si shqiptar.

Si shqiptar që jeton në Itali prej vite-sh, si u ndjetë kur 30 mjekët dhe infermierët shqiptarë erdhën në Itali për të ndihmuar kolegët e tyre në përballimin e pandemisë së shkaktuar nga COVID-19?

Po u ndjeva mjaft mirë që shqiptarët u treguan të gatshëm për të ndihmuar popullin italian në përballimin e pandemisë, shkaktuar nga COVID-19. M'u kujtuan vitet e vështira të eksodit të shqiptarëve pas 90-ës, kur italianët na pritën në gjirin e tyre dhe na ndihmuan pa kushte, gjë të cilën vazhdojnë ta bëjnë edhe sot në drejtime të tjera, siç është ajo për integritetin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Fjalët e Kryeminsitrit tonë "Shqipëria nuk është një vend i pasur, por gjithashtu nuk është një vend me memorie të shkurtër", patën jehonë të madhe në mediat dhe opinionion italian. Një fakt i tillë të gjithë ne shqiptarëve, që jetojmë në Itali na bëri krenar që jemi shqiptar.

A ke në plan për të hapur ndonjë ekspozitë në Shqipëri.

Po, një nga ëndërrat e mia është ajo që të hapë një ekspozitë në Shqipëri e sidomos në Vlorë, në qytetin tim të lindjes.

Megjithëse jeni lindur në Berat, pasi babai juaj ishte ushtarak, por origjina juaj është Kallarati, sa kallaratas e ndjen veten dhe sa shpesh shkon atje? Çfarë mund të kujtosh për të afërmit e tu atje, por në përgjithsi për njerëzit dhe natyrën e bukur?

Jam krenar të kem origjinën nga Kallarati për faktin që kam kaluar ato vite të fëmijërisë, ku u rrita nën përkujdesjen e gjyshes time aq të mirë e aq gojëmbël, siç ishte Pajame Ribja dhe të xhaxhait tim Hekuran Ribit, njeri shumë punëtor e i thjeshtë, njeri pa llafe dhe me shpirt sakrifice, që asnjëherë nuk u largua nga Kallarati. Dhe për këtë motiv unë e quaj veten kallaratas me plot gojë, paçka se kam jetuar dhe kam mbaruar shkollën në Berat.

E shikoj që ke nostalgji e mall për Kallaratin, çfarë mendon se mund të bësh për Kallaratin, gjithmonë e lidhur edhe me profesionin tuaj të piktorit?

Po është e vërtetë. Për Kallaratin kam shumë mall e nostalgji. Sa herë që kthehem në Vlorë dëshira ime është gjithmonë të vete dhe të çmallem me ato shtufe, të shikoj atë mal të bukur të Bogonicës që ngrihet si një shqiponjë me dy krahë të hapura, që duket sikur do ta mbrojë nga e keqja atë fshat. Një nga dëshirat e mia do të ishte të pikturoja "Fshatin e Djegur", ashtu siç ka qenë para djegjes së tij nga andardët grekë në vitin 1914, me shtëpitë e tij të bukura, i vendosur në një pllajë rrëzë Bogonicës. Por do të kisha nevojën

e një gojëdhënësi për të rrëfyer se në çfarë mënyre dhe ku ndodheshin pak a shumë fiset e kallaratasve. Ky është pikësynimi im dhe kam besim se do ta realizoj.

Babai juaj Caushi, i ndarë nga jeta para kohe, përveçse një ushtarak i zoti, prind i shkëlqyer, ishte shumë i dashur me njerëzit e në veçanti me bashkëfshatarët e tij kallaratas. Çfarë kujton sot për të dhe çfarë cilësish mendon se ke trashëguar prej tij?

Për babain tim, ndjesë pastë, do të thosha që ishte një baba i rrallë, jo se ishte babai im, por ashtu ishte. Ishte një baba që ne fëmijëve na trajtonte si shokë e jo si baba. Ai nuk mërzitej asnjëherë, ishte gjithmonë buzagas dhe nuk e nxirrte asnjëherë fjalën e keqe nga goja. Ishte i dashur me shokët dhe bashkëfshatarët e tij dhe sa herë takohej me ta gëzohej pa masë sikur t'i kishte vëllezërit e tij. Mendoj, që karakteri i tij emocionant, të ketë lënë gjurmë në jetën time artistike. Ai ishte me emocione të mëdha si një artist. Ky ishte babai im, Caush Ribaj, i cili më mungon shumë.

Po nga nëna juaj Zelihaja, bijë nga Bolena, e cila jeton me ju në Itali, çfarë ke marrë?

Nga nëna ime mendoj se kam trashëguar karakterin e fortë dhe të palëkundur. Ajo i qëndroi besnike dhe i shërbeu me shumë devotshmëri babait tim gjatë gjithë kohës që ai lëngoi nga sëmundja e gjatë. Ajo sakrifikoi gjithçka për t'u përkujdesur për të dhe për t'i dhënë sadopak shpresë për t'u përmirësuar, por fati nuk e deshi, sëmundja e rëndë më në fund i mori jetën. Megjithatë ajo nuk u përkuq asnjëherë deri sa ai mbylli përgjithmonë sytë.

Cila është familja juaj, por diçka edhe për motrën dhe vëllezërit?

Familja jonë është një familje e thjeshtë, pa shumë lëvdata dhe bujë. Unë me dy vëllezërit e tjerë, Sokolin dhe Boron, ikëm shpejt që të vegjël në emigrim, ku u ndeshëm me shumë rebeshe dhe stuhira të jetës së emigrantit, por tani kemi krijuar familjet tona dhe jetojmë në harmoni me njëri - tjetrin, kemi dhe një motër në Tiranë, Eraldën, e cila edhe ajo ka krijuar familjen e saj. Jemi ca të larguar e ca në Shqipëri dhe mezi presim të të vijë vera, të hapen rrugët e të çmallemi si gjithë shqiptarët e tjerë në mërgim. Ndërsa familja ime përbëhet nga bashkëshotja Irena, vajza Iri dhe djali Klajdi. Mendoj se bëjmë një jetë të thjeshtë, modeste, por të bukur dhe ndihemi përherë të lumtur.

Ndonjë mesazh për kallaratasit?

Mesazhi im për kallaratasit është: "Të vazhdojnë kështu si përherë, të duan njëri - tjetrin dhe kudo që ndodhen të ngrenë akoma më lartë krenarinë e Kallaratisit dhe t'u tregojnë edhe njerëzve të tjerë, që Kallarati ka qenë dhe është një fshat i bukur me njerëz të mirë, të urtë, punëtorë, bujarë e mikpritës, me dëshmorë e heronj të lavdishëm në shekuj në historinë e gjithë Lumit të Vlorës, që nuk u përkuq asnjëherë përpara turkut, grekut, gjermanit dhe italianit dhe mbi të gjitha mbijeton gëzimi e hareja e krenaria për t'u quajtur kallaratas. Motoja e shoqatës "Ec ngado, por Kallaratin mos e harro!", le të na shoqërojë të gjithëve, në veçanti atyre si puna ime, që jetojnë e punojnë jashtë atdheut".

Faleminderit!

Ndahet nga jeta doktoresha Zyliha Kraja

Kirurgu i njohur, Arben Beqiri ka reaguar për ndarjen nga jeta të koleges nga Shkodra, Zyliha Kraja, e cila ka humbur betejën me koronavirusin.

Në një shënim në rrjetet sociale, Arben Beqiri thekson se Zyliha Kraja bënte pjesë të drejtuesit e

rëndësishme të kirurgjisë, të cilët kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm.

“Zyliha Kraja, një emër, që më ka përcjellë që kur kam qene student ne mjekësi dhe shkoja pas Dr. Ali Spahise për praktike ne Spitalin Jorgji Karamitri!”, thekson ai.

Kirurgu i njohur kujton dhe bisedën e fundit që ka patur me Zyliha Krajën.

“Një muaj me pare me telefonoi, për te me shprehur opinionin e saj për një emis-ion mbi mjeket e rinj. Ishte me te drejte krenare qe ne moshën e saj 80 vjeçare dilte çdo dite ne spital dhe shprehej se do vazhdonte deri sa te mos kishin nevojë për te!”, thekson Beqiri

Mesazhi i plotë i Arben Beqirit

Zyliha Kraja, një emër, që më ka përcjellë që kur kam qene student ne mjekësi dhe shkoja pas Dr. Ali Spahise për prak-



tike ne Spitalin Jorgji Karamitri!

Spitali i Shkodrës kishte mjekte te mëdhenj, shume te afte per nga profesioni, te jashtëzakonshëm per nga personaliteti, shpirtëra te lire e te panënshtuar edhe ne diktature!

Mark Mirashi me një disipline Gjermane dhe teknike kirurgjikale te pastër, Ramiz Hafizi një erudit qe mund te barazohej vetëm me një biblioteke, Ferit Hoti

me nje humor dhe ironi pozitive qe nuk linte asnjë ta zinte gjumi, dhe per nga pergatitja fizike krahasohej edhe me nje kampion te peshëngritjes.

Zamir Shazi aq i sjellshem dhe etik gjithmone i gatshem te te ndihmonte dhe te ftonte ne operacione.

Ali Spahia kirurgu i jashtëzakonshëm qe kishte realizuar ne Dukagjin ndërhyrje qe ishin jo te lehta per kolege ne qendra universitare, qe burgu politik nuk e pengoi te ishte me i liri mbi te gjithë, qe udhëhoqi lëvizjen demokratike te Dhjetorit ne Shkoder.

Dhe ne mes tyre qëndronte e vetmja femër, kirurge, drejtuese, ekuilibri, dhe disiplina e një grupi kirurgjikal me vibranti, me intelektual dhe me i jashtëzakonshmi qe kam pare ndonjëherë kudo ku kam qene e kam udhëtuar (dhe kam pare e udhëtuar jo pak), Dr. Zyliha Kraja!

Dita e punës ne këtë mjedis ishte e veçante, njeri te sillte nje libër te ndaluar, tjetri recitonte me qindra vargje te Dostojevskit, nje tjetër këndonte opera, dikush recitonte me qindra vargje te Lahutes se Malësisë se Fishtës.....kujdesi për pa-

cientet me ato kushte dhe mjete ishte i jashtëzakonshëm.

Lejla Tukiqi nje tjetër kirurge e talentuar me te drejte shprehej “mezi pres te shkoj ne pune ne mëngjes”. Ishte e plotësisht e vërtete! Te gjithë prisnim me padurim.

Sot dirigjentja e kësaj orkestre virtuoze nuk është me mes nesh! Covid 19 u fut tinëzisht mes saj dhe pacienteve pasi ishte ne këmbë ajo nuk u nda pre tyre.

Një muaj me pare me telefonoi, për te me shprehur opinionin e saj per një emis-ion mbi mjeket e rinj. Ishte me te drejte krenare qe ne moshën e saj 80 vjeçare dilte çdo dite ne spital dhe shprehej se do vazhdonte deri sa te mos kishin nevojë për te!

Falenderonte ekipin aktual te mjekëve, trashëgimtare te denje te brezit vjeter, qe i krijuan nje ambient te kendshem pune. Ai ambient profesional me shoqëron gjate gjithë karrierës time si kirurg!

Do na mungoje Dr. Zyliha Kraja!

Koresp. i gazetes
“DUKAGJINI”

ARBËRESHËT DHE KRISHTËRIMIT

- reflektim nga Giuseppe Chiaramonte -

Në krishtërimin mesjetar, në një nivel zyrtar, popujt nuk njiheshin si etni, por sipas përkatësisë fetare. Prandaj, dallimi midis grekëve dhe latinëve, korrespondon me përdorimin liturgjik të greqishtes ose latinishtes. Një dallim tjetër: lindor dhe perëndimor, dhe së fundmi: ortodoks dhe katolik.

Perandoria Romake Lindore që më vonë u bë Perandoria Osmane, megjithëse në të vërtetë ishte multi-etnike, i konsideronte subjektet si latinë, romakë/romë, muslimanë / myslimanë, hebrenj. Termi albanoi, duke zëvendësuar ilirët, haset për herë të parë në Ana Komnena. Duke u ankuar për frakturën e tyre me grekët, me të cilët ata kishin mbajtur në këmbë fatin e Perandorisë. Midis fuqive që, ndër kohë, kishin gdhendur territor brenda Perandorisë Lindore, përfshijmë Venedikun. Një nga fushat e tij ishte Peloponezi, ku grekfolësit dhe shqipfolës jetuan krah për krah dhe shkëmbyen të dy gjuhët. Sidoqoftë, shumë dokumente dëshmojnë se Venecia preferonte shqiptarët ndaj grekëve, sepse i konsideronte ata më besnikë për mbrojtjen e fortesave të saj (shiko konceptin e besës). Edhe emri mesjetar i Peloponezit rrjedh nga shqipja man/mën, domethënë mora, nga ku Morea.

Pushtimi i Ballkanit kalon në faza të ndryshme ndërhyrje (ishte Gadishulli Ilirik, pastaj Romënia dhe pastaj Rumelia dhe Ballkani). Popullsia shqiptare e Jugut (toskët) dhe ajo e Moresë (arvanitët), e lanë rajonin masivisht dhe u strehuan në Mbretërinë tonë Jugore; Napoli dhe Sicili. Regjimi, atëherë në fuqi, bëri që emigrantët të përceptoheshin si grekë, pasi ata nuk ishin latinë.

Ky rezultat gjithashtu do të arrihej për

shkak të tre elementëve vijues:

- refugjatët kishin një ritual të ndryshëm në liturgji, por gjuha e përdorur ishte greqisht,

- dallimi midis grekëve dhe latinëve ka ekzistuar paraprakisht në Sicili (shiko Letrat e Gregorit të Madh dhe tre pjesën etnike të Mbretërisë Siciliane Normane),

- zotëriminjtë feudalë, në zotërimin e të cilëve ishin pritur refugjatët, ishin kryesisht kishtarë.

Si të tillë ata privilegjuan dallimin fetar. I quajten grekë. Shkrimtarët e gjërave siciliane, nga Fazelo e tutje, dhe dokumentet noteriale, sidoqoftë, flasin për “graeci seu albanenses” (greqët apo shqiptarët). Të dy termat tregojnë, nga njëra anë, dallimin zyrtar për sa i përket Krishterimit dhe nga ana tjetër, vetëdijësimin e identitetit të refugjatëve si “Arbër”. Në nivel popullor, sidoqoftë, emrat ishin të ndryshëm: simbol i kreut të grekëve, ishte një varëse me kokën e shqiponjës, e përdorur nga judenjtë e Spanjës për shqiptarët, që tregon natyrën e tyre kokëfortë dhe të vendosur në mirëmbajtjen e gjuhës dhe traditave të tyre;

gjegjë, nga ndër lidhja e pyetjes “gjegjë”? = keni degjuar?

Jartù, nga mënyra e thënë; eja këtu, e korrigjuar në “eja rtu” = eja këtu.

Rasti i “La Pianës”

La Piana fillon rrëzë qytetit të Pianës të shqiptarëve dhe shtrihet deri në Merugat, në territorin e Shën. Kristina Gelës, në kufi me Marineon. Ajo është e mblyllur midis Kazagotit, maleve Kumeta (shqip. Kumajt), Maganocit, Leardos dhe Roselës / Turdiepit, në jug-perëndim dhe arrin deri në lartësitë e Mëndrës dhe Muzakjës, Kosta Marciones, Firratit, Baga-

letetit, Gurit të Korvit dhe Sëndahstinës, në lindje. Nuk e dimë se si u nda ky territor në periudhat romake dhe bizantine, ndërsa nga dokumentet normanë ajo ndahet midis qytetit të Palermos dhe qytetit të Jatos. Kufiri i përbashkët është Destro Belice. Pjesa që ka të bëjë me Palermion është dhënë Arqipeshkvit të Palermos më 12 shkurt 1095-ën, me privilegjin e Kontit të Madh Roxher. Prandaj emërtimi i parë ishte Piana e Arqipeshkvit. Në 1182-in, Mbreti Ëilliami II, i Miri, ia dha pjesën që kishte të bënte me Jatton, Dioqezës së Monreales, që ishte krijuar rishtas. Emërimi “Piana e Arqipeshkvit” shtrihet edhe në këtë pjesë. Duket se më parë zona ishte menduar të quhej, “Lugina e Ferrit”. Ndoshta për shkak të pyjeve të dendura dhe gjembave, apo për shkak të rraskapitjes së forcës punëtore të kolonive arabe, ose për shkak të pranisë së humnerës së tmerrshme të Honit. Me vendosjen e arbëreshëve në pjesën malore të zonës së Monregaleses, konglomerati i kasolleve, së pari, dhe shtëpive, më vonë, u quajt “Shtëpia e Grekëve” nga administrata Arqipeshkvnore. Ndërsa arbëreshët e tjerë i quajten Kazallot / Kazallonë. Duke u zhvendosur më tej, në vendbanimin në rrjedhën e poshtme, pothuajse duke prekur fushën, ne fillojmë të flasim për “Shtëpitë e Pianës”. Me administratën feudale (1812) dhe duke pasur parasysh lindjen e komunave në Sicili (1 janar 1818), administrata Borbonike, u kërkoi zotëriminjtë feudalë që komunave të ardhshme, tu caktonin emrin dhe stemën e tyre. Për konsideratat e mësipërme, Arqipeshkvi – baron, e emëroi “Piana e Grekëve”. Si pasojë, ky emërim, u bë emër zyrtar për komunën e re. “Piana e

Grekëve” kishte stemën e saj komunale, që përmbante shqiponjën me dy koka në qendër, e rrethuar nga fjalët “Nobilis Plana dhe Albanensis Civitas”(Plana Fisnike dhe Shteti i Shqiptarëve). Kjo kontradiktë e dukshme duket se u ka shpëtuar studiuesve, duke lënë hapësirë për shumë rindërtime dhe shpjegime, shpesh tendencioze, si në Itali ashtu edhe jashtë saj (Greqi). Sidoqoftë, jo për kontradiktë, por bëhet fjalë për një qasje të dy mënyrave të ndryshme mendësie;

Kryepeshkvi, për sa i përket përkatësisë etnike, ende arsyeton në aspektin zyrtar të Krishterimit, Juristët dhe Familitari.

Nga ana tjetër, mbishkrimet S.P.Q.A. (SENATUS POPULUS QUAE ALNANSIS), (Senati i Popullit Shqiptar) dhe N.P.A.C. (NABILIS PLANAE ALBANENSIS VIVITAS) (Plani i Paqëndrueshëm i Borxhit ndaj Shqiptarëve) i shohim të mahnitshme në veprat publike arkitekturore.

Konfuzioni midis ritit Grek – që sot duhet të quhet Bizantin – dhe Greqia etnike, duhet të refuzohet, ashtu siç duhet të refuzohet barazimi Ortodoks = Grek dhe Bizantin = Grek. Termi “Bizantin”, i përdorur për herë të parë në mesin e shekullit të tetëmbëdhjetë për të treguar një fazë të gjuhës greke, më në fund na ndihmon ti shohim arbëreshët si shqiptarë të lashtë të Italisë, dhe kishën e tyre si Bizantine – arbëreshe (jo më Greke dhe as Bazantine).

Kështu përmbledh zyrtarisht Libri Vjetor Papnor.

Përktheu:
Nikolin Sh. Lëmezhi

GJONI DHE KLINTONI!

Ishte tu ra borë e fry veriu si do Zoti vetë.

Qebesa mos praftë nesër nuk del njeri jashtë - i tha Liza, Gjonit që i kish kthye shpinën oxhakut tu pi një kungull venë e tu rruftitë dyreçka mishit thiu të egër.

-Mos u mërzi grue se sha zotën kush ma lehtë, se na nuk e ka me kalie këtë dimën borëplot.

Dru zgorani boll, tagji deng për lopë sa t'i zanë zhaba, trinën vrantë me mish thiu të butë e të egër, vozgat rrafsh me venë e raki, djem e çika në Miçigam. Shëndetin bereqavers veç moteve nuk mund po ua ndalin rrokullimën.

-Vetë i kena hagër burro e nuk po kemi pse kjahemi....

-Grue ma jep telekomondën të ndërroj një kanal se po due me pa lajmet.

-Burra, po shohim mbretin e botës, Sulltan Sulejmanin, sonte lindë Hyrremi fëmijën e katërt e nuk po di ç' ka "falë Zoti" djalë apo çikë!

- Unë jam Zoti shpisë e due me pa lajmet për Zotin e Tokës!

-Qebesa asht hera e tretë që i sheh sot të njajta rrena politike.

-Po due me ditë si përfundoi skandali Levinski.

-Ç' ka a kjo more njeri?

-Monika Levinski zyrtare në Shpinë e Bardhë i kanë dalë do fjalë Klintonit e boll keq më ka ardhë! Ju ka shpifë shejtanja, se shazotën nuk ka pas grimë nevojë me kapë?

-Si tetanë burrat, po u doli gja përpara nuk të falin.

- Ai nuk asht si te tjerët, Klintoni asht

ëngjelli mbrojtës i Kosovës e qebesa ma pare baj të m' na cofë lopa me gjithë viç se me shkarkue prej detyre pse i kruhet të një gruaje!

-Mos ki frikë se asgja si ka ba keq veç ç'ka i ka lypë dhimta e shtatit!

-Nuk e besoj, asht burrë i ndershëm dhe ka vu dorën mbi bibël dhe kushtetutë!

-Edhe Monikës i ka vu dorën në plagë për bekim!

- Nji kryeplak katundi ka dy tre mike-sha, e jo ma Klintoni si yll i ramë prej qielli që vra e kthjellë gjithë botën!

-Grue me të pëvetë për diçka, por pashë ket natë më kallëzo të vërtetën?

- Asht Zoja e Frorit sonte e mos më tundo more njeri.

-Shazotën nuk po të pyes për ç'ka nuk din me dhanë përgjigje.

- Ti fol një herë se ke qitë be të madhe.

-Me ba me këne sekretarja e Klintonit dhe atij i pigalezet mendja me tu lutë, c'ka kishe me i thanë?!

-Lene burra atë shpoti se gruaje e pushka nuk gerdhucën vend e pa vend?

-Amaneti asht i randë e nuk e mban as toka por fol drejt e pa hile!

-Qebesa more me thanë të drejtën me dorë në zemër at farë robi, nuk kisha mujtë me kthye prapa pa kurr farë ndere!

-Grue tungjatjeta! Kjoshe e plaknosh, se pasha jetën e pasosun njiqind herë t' mu kishe betue ndrysh nuk ta kisha besue!

Prele Milani

Nga Skënderbeu i Nolit me lirinë, te post diktatura e tiranokratëve me hajninë!



NGA BESI BEKTESHI

Deri përpara disa viteve sigurisht që i vija një faj të madh, por dhe të përveçëm klasës politike për gjendjen kolaps dhe inkopatibël me demokracinë dhe me lirinë. Po pra po, mendoja se e ka fajin ajo. Por sot që ka disa vite kjo ide jam i bindur se e ka fajin shoqëria jonë folkpolitike dhe retro kulturore. Një shoqëri që ka dalë në një pjesë të madhe të saj nga "brigandizmi shqiptar" i kohës së pashallëqeve dhe fundit të Perandorisë Osmane. Po, kaçakë, grabitës rrugësh, karvanësh dhe fshatrash si mënyrë jetese në pasurim. Po ti shtojmë sidomos fundin e diktaturës që grabitjes dhe vjedhjes masive të ndërmarrjeve dhe çdo gjëje të shtetit nga skamja fantastike atëherë kemi të bëjmë akoma më një shoqëri që nuk është bindur se hajnia, grabitja apo vjedhja, nuk janë nder dhe nuk janë moral. Janë në të gjithë kohët turp dhe e keqe e madhe, që mund të të bëjë të pasur, por mbetesh burrë i keq në çdo rrethanë dhe kohë. Aq më tepër në politikë dhe shtetformim. Mu kujtua fjalimi i Skënderbeut në Krujë, i treguar nga Barleti dhe më vonë i përpunuar disi nga Noli, që janë të dy fantazmagorikë frymëzues kombëtariteti deri në legjendë kthyer, por që kanë pasur të drejtë për të frymëzuar ndjenjë kombëtare. Ata kanë dashur

të vendosin në gojën e Kastriotit lirinë që po gjente te populli. E Barleti thotë: "Lirinë nuk e solla unë, por e gjeta këtu. Sapo më shkeli këmba truallin tuaj, sapo dëgjua emrin tim, m'u derdhët me vrap të gjithë, më dolët përpara kush e kush më parë". Kurse Noli e ka kështu: "Lirinë mund ta kishit fituar me trimërinë tuaj se nuk i mungojnë burrat, po ju pëlqeu ta prisni nga dora e ime, ndonëse vonë, se kështu ndofta desh vet i madhi Zot. Se është me të vërtetë çudi që trima kryelartë si ju, të rritur në liri, duruat kaq kohë robërinë e barbarëve, duke pritur të më shikoni një ditë në krye tuaj. Po vallë, a e meritoni këtë titull të bukur të çlironjësit që kini mirësinë të më jipni? Lirinë s'jua solla unë, po e gjeta këtu, në mes tuaj. Posa shke-la këmbën këtu, posa dëgjua emrin, renttë që të gjithë, më dualtë përpara kush e kush më shpejtë, sikur t'ishin ngritur nga varret atërit, vëllezërit, bijtë tuaj, sikur të kishte zbritë nga qielli vetë Perëndia. Më prittë me aq dashuri dhe gëzim, më sualltë aq shërbime të çmuara e pa numër, sa më bëtë më tepër ju robin tuaj sesa unë të lirë ju".

E bukur sigurisht. Por, a u transformua e gjithë kjo mrekulli patriotizmi dhe frymëzimi lirik në post komunizëm te ne? Sidomos mbas daljes në liri dhe fillim të demokracisë me ardhjen në majë të tribunave të atyre që mundohen t'i ngjanë Skënderbeut. Po pra Berisha dhe Rama dhe Meta kryesisht, sepse Nano as që është marrë me këtë gjë përveç faktit kur i shkruanin fjalimin "Jam Fatos Nano dhe mbrapa më vjen historia" pothuaj si I. Qemali. Por dhe burra të tjerë që nuk kanë bërë asgjë tjetër në rrugën e shtetformimit

tonë në demokraci përveç se o kanë vjedhur (akuzuar) o janë brigandë të fondeve ose tenderave, o degradues të ekonomisë shkatërrimit dhe lejimit të mynxyrave të mëdha financiare. E ne që jetuam vitet e fundit të diktaturës dhe këto të post dik-



taturës apo demokracisë kuptuam një gjë. Shtetërim dhe pushtetërim në post diktaturë nuk do të thotë asgjë tjetër përveç se vjedhje. Asgjë më tepër dhe më pak se sa kjo. Vjedhje kudo dhe në çdo gjë për 30-të vite nga diktatura dhe këtej. Po pra për fat të keq vjedhja ka kult, pranohet dhe është e madhe apo e rëndësishme, kur një shoqëri nuk e refuzon atë politikisht dhe moralisht, por dhe filozofikisht. Politikisht, sepse pjesa më e madhe kanë akuza për vjedhje apo dhe grabitje me arrogancë të parave të shtetit, moralisht se

tregon se paskan pasur këtë moral dhe edukatë dhe filozofikisht sepse vjedhjen e kanë vënë si mënyrë jetese. Pra vetëm kështu mund të jetojë një tarikat politik i tillë. Për vjedhjen e madhe dhe të sigurtë ju duhet dhe politika dhe të gjitha hallkat e saj përfshi shtyllat e shtetit sidomos drejtësia. E kështu i kanë pasur dhe i kanë gjithmonë. Të gjithë "derbederët" e ardhur në pushtet në Shqipëri (mbas 90-ës) fjalimin e tyre të "Krujës" e kanë kështu: Hajninë nuk jua solla unë, por e gjeta atë mes jush. I them hajninë se rimon apo tingëllon më mirë, sipas meje. Bie fjala më mirë se si: vjedhurinë apo vjedhjen nuk e solla unë atë e gjeta këtu mes jush? Tashmë kjo është bërë esencë e marrjes dhe lënies së pushtetit politik në Shqipëri. Atij pushteti që nuk merret as me qytetarin dhe as me shtetin. Por që merret vetëm me hajninë si të qytetarit dhe shtetit. E pse kjo gjë?? Sepse shoqëria jonë e ka akoma brigandizmin dhe hajninë pjesë të raciales dhe jo të refuzuar si mënyrë jetese. Kur një shoqëri nuk refuzon hajninë, ajo sjell në pushtet kryehajnat e saj dhe këtu mbaron diskursi mbi shtetin, pushtetin dhe shoqërinë në demokraci. Të gjithë këta derbederë justifikohen me fjalinë: Hajninë nuk jua solla unë, por e gjeta mes jush. E ata që janë ndryshe nga këta të këtij tipi shoqërie që nuk refuzon vjedhjen si mjet pasurimi dhe jetese prej gojës dhe mendjes së politikanëve të atij tarikat këtë fjalim dëgjojnë përditë: Hajninë (vjedhjen) nuk jua solla unë, atë e gjeta në mesin tuaj. E kur kjo përsëritet orë e çast dhe kur njerëzit e mendojnë orë e minutë duket gati gati si e vërtetë.

Fibromyalgia



Dr.med. Ndue Nikaj

Ka akoma sot mjek që nuk e njohin fibromyalgin. Ky afeksion i dhimbshëm dhe i keq-përcaktuar si nozologji provohet të lehtësohet kur takohet një person, që është mbartës i saj. Nëse ju merrni në kohën e duhur një program mjekimi të efektshëm mund të futeni në rrugën e shërimit.

Çfarë është fibromyalgia?

Fibromyalgia do të thotë “dhimbje në muskuj”, nocion i përcaktuar kryesisht me ane të shenjave klinike (simptomave). Nuk njihen shkaqet deri më sot. Mund të përjetohen dhimbjet e përgjithshme si dhimbja e kokës, pagjumësia ose agjitimi në gjumë, po ashtu dhe një mori shenjash të tjera që i provojnë të sëmuret dhe që janë reale. Nuk ekziston asnjë test laboratorik, që të na mundësoj diagnozën dhe asgjë nuk na vërteton praninë e sëmundjes. Ja perse ju keni të drejtë të shkoni nga një mjek tek tjetri deri sa të vendoset diagnoza e juaj. Ekspertet mendojnë se fibromyalgia e ka origjinën e saj në tru dhe lidhet me një deficit të SEROTONINES, një transmetues kimik i sistemit nervor. Femrat janë veçanërisht të ndjeshme ngaqë kanë nivel të ulët serotoninës, gjë e cila mund të shpjegoj arsyen pse nga 10 të sëmurë 9-jane femra. Ato vuajnë po ashtu më tepër se meshkujt dhe nga migrena (hemicranias), sindromi i zorrës së irrituar (colit spastik) nga depresioni, ankthi, krize paniku si dhe turbullime të tjera, që shoqërojnë si rregull deficitin e serotoninës. Kur ka mungesa të serotoninës, organizmi është më i predispozuar për të vuajtur nga gjendjet stresuese. Një person nën efektin e vazhdueshëm të stresit ka tkurrje muskuljsh, predispozita për një seri ngjatjesh shkatërruese, cilësia e gjumit është e keqe varet po ashtu nga rezervat e serotoninës dhe me sa duket gjumi me shqetësime turbullon aftësitë memorialë dhe provokon fibromyalgia rendimin e saj.

Krijohet kështu një lloj rrethi vicioz: dhimbjet muskulare prishin gjumin, thellohet lodhja, mungesa e gjumit gjeneron ankth, hutim deri në depresion. E gjitha kjo akoma më tepër kontribuon në spiralen e përfshirjes në një stres të pakontrollueshëm, gjë e cila mund të çojë në fibromyalgi. Plagët, infeksionet, çrregullimet hormonale mund të bëhen shkak që mos të kemi siguri.

Trajtimi i fibromyalgis

Kërkoni mjekut tuaj t’ju jap një anal-

gjik të mirë kundër dhimbjes .

Nëse ndjeni nevojë, merrni një qetësues për të fjet.

Mjeku juaj mund t’ju përshkruaj një anti-depresiv që rrit nivelin e serotoninës (si p.sh. paroxetine e të tjera)

Përpiquni të përcaktoni faktorët që ju shkaktojnë stres ose që ju sjellin ndryshime të papërshtatshme, si p.sh. ju mund të merrni një teknik relaksuese: për të lehtësuar fibromyalgin ju mund të merrni një banjo të gjate me ujë të ngrohtë dhe kripëra EPSOM, që përdoret si një mbulues elektrik, bëni masazh të

përjavshëm, një trajtim me akupunktur, aeroabi pa kaluar në lodhje,

merrni një relaksant muskular muskoril) ose dhe anti-depresiv. Të gjitha këto mbështetje ndihmojnë njëra tjetrën, por mbetet të vërtetoni atë që ju bën më mirë. Nëse ju kaloni një periudhë stresuese dhe nuk arrini ta zgjidhni, duhet të konsultoheni me një terapeut, i cili ka experience në trajtimin e të sëmurëve me fibromyalgi. Para se të filloni një trajtim, është mirë, që të bëni ecje të gjata. Sepse personat që vuajnë nga ky afeksion prej një kohe të shkurtër reagojnë shumë më mirë ndaj trajtimit, se sa ato që vuajnë prej një kohe të gjate (10-vite p.sh).

Disa ilaçe kundër fibromyalgis. Në qoftë se jepet në kohën e përshtatshme ilaçi mund të ndryshojë për mirë ecurinë e cilësisë së jetës së pacientit. Mjeku ndërmerret zakonisht një trajtim për grupe të ndryshme simptomash me ilaçe specifike. Kështu që analgjiket mund të lehtësojnë dhimbjen muskulare. Acetaminofeni (paracetamoli) rekomandohet shpesh, por në raste të tjera përdoret një ilaç më i fuqishëm, dhe në raste të veçanta mjeku mund të përcaktoj opioide si morfina ose hydrocodone në forme tableta ose fentanyl në forme leokoplasi (duragesic), e cila vepron në sistemin nervor duke lehtësuar dhimbjen nga që dhimbja nuk perceptohet. Megjithatë duhet të shqetësohemi se kanë rrezik të lartë varësie. Mund të përdoret tramadoli ose kombinimi tramadol-paracetamol, po ashtu dhe naproxeni me codein (apranax plus). Zgjidhje të mirë mund të përbej ky kombinim, i cili krijon pak varësi. Anti-infamamatorët jo steroid (AINS) si aspirina, brufeni nuk mund të jenë të dobishëm në fibromyalgi pasi ajo nuk është me origjinë inflamatorë. Në disa raste dhimb-



ja qetësohet shpejt me anën e një injeksioni anestetik Lidocaine në pikën muskulare të prekshme. Përdorimi i dozave të vogla të antidepressive mund të rregulloj turbullimet e gjumit të ardhura nga dhimbja dhe lodhja. Njëkohësisht këto ilaçe përdoren për të hequr depresionin, që në një numër rastesh vjen nga ç’rregullime të ekuilibrit të serotoninës. Por në të varetë do të ishte më e përshtatshme, të cilësohen mudoluesit e serotoninës ngaqë ato kanë efekt në rritjen e nivelit të neurotransmetueit në tru. Sidomos antridepresivet treciklik

syrel) nëse ka pagjumësi mund të përdorin sedative të lehte në doza të vogla, si stilnox (zolpidem) ose zoleplon (sonata 5-10mg), që mund të kenë veprim të mrekullueshëm. Së fundmi mund të jete më shumë dobi si gjumë sjellës potent dhe relaksantet muskular cikloo-benzaprina (flexeril), i cili mund t’ju ndihmoj. Po ashtu sot përdoret si mjekim ndihmës pregabalina (lyrica) 75 mg (1 x 2) nga goja Ndryshimi i stilit të jetës.

Përshtatni një numër zakonesh të përditshme, që mund t’ju ndihmojnë për mirë.

-Menaxhoni dhe shëroni stresin tuaj


-menaxhoni forcat dhe angazhohuni aq sa mundëni, brenda një limiti të caktuar sipas forcave tuaja

- bëni rregullisht ushtrime: filloni seanca javore aerobie, bëni not sa më shumë, bëni ecje me rritje graduale gjë e cila mund t’ju lehtësojë dhimbjet muskulare.

Ndiqui terapi, flini mjaftueshëm (7-8 ore) dhe mos shkoni në krevat për tu shtire, por vetëm për të fjetur. Për trajtimin e fibromyalgis ndihmon psiko-terapia e njohjes dhe e sjelljes. Teknika e relaksimit me meditim, me joga, biofeedback, schiatsu, masazhet relaksuese mund të ndihmojnë në lehtësimin e stresit dhe dhimbjes sidomos në dhimbjet e mire-përcaktuara. Akupuntura po ashtu, vendosja e gjilpërave të imta në pika strategjike të trupit dhe sot po ndërmerret një kurs Qi gong e mjekësisë tradi-

cionale kineze, që prej 4000 vjetësh me lëvizje dhe përqendrim duke drejtuar dhe fryme-marrjen për të shmang stresin.

Pra, siç thamë më lart vendosja e diagnoses fibromyalgi është supozuese dhe e veshtarë dhe nga ana tjetër duhet që të sëmuret të mos marrin analgjezik pa u këshilluar me mjekun personal.



Pikat e dhimbjes

si amitriptilina (laroxil) shërbejnë si analgjezik të mirë. Anti-depresivet e familjes se re ISRS inhibitorserotoninës si p.sh. fluoxetine (prozac) sertalina (zalloft) ose paroxetine (paxil). Ato ndihmojnë në reduktimin e depresionit. Përshkruhen dy lloje ilaçesh në doza të vogla.

Së fundi, është një qarkullim një tjetër familje anti-depresivesh që lehtësojnë shenjat e fibromyalgis si trazadone (de-

PSE EVROPA HEZITON TË NA PRANOJË NË GJIRIN E SAJ?!



Nga Gjon BRUÇI

Para disa vitesh, kur dëshirës së shqiptarëve për t'iu bashkuar BE-s, kjo e fundit iu përgjigj me një qëndrim skeptik dhe dyshues, (dyshim e skepticizëm që po vijon edhe sot), intelektualët tanë të shumë fushave, hapën një debat të zjarrtë, për identitetin nacional të popullit tonë. Në qendër të këtij debati, u vendosën dy figurat qendrore të inteligjencës sonë, Profesor Rexhep Qose, dhe shkrimtari i mirënjohur, Ismail Kadare, të cilët u përpoqën të argumentonin, secili sipas pikëpamjes së tij, identitetin e shqiptarëve, si shkakun e afrimit ose jo të vendit tonë me Bashkësinë Evropiane.

Debati i mësipërm tashmë ka kaluar, por çështja për të cilën u zhvillua, është sërish në rend të ditës. Tri dekada kërkesa e refuzime për t'iu bashkuar Evropës, nuk janë pak, për një popull e një vend, që pretendon se është nga banorët e parë të Kontinentit plak.

Pse kemi ngecur në këtë rrugëtim tre dekadash? Sa e gjatë do të jetë kjo rrugë?

Po përpiqemi të japim disa konsiderata modeste, pa kërkuar debat me figurat e shquara të vendit, çka do të ishte jashtë mundësive tona.

Raporti shekullor midis shqiptarëve dhe evropianëve

Raporti i marrëdhënive, midis shqiptarëve dhe evropianëve në të gjitha kohërat, është zhvilluar në dy plane: në planin zyrtar, dhe atë qytetar. Ky i fundit, raporti qytetar, për nga cilësia, në të gjitha kohërat ka qenë në shkallën më të lartë. Po marrim tri raste pikante: nga historia e lashtë, mesjeta dhe kohët moderne:

A nuk ishte mbreti ynë Genti, që pranoi të ulej në bisedime me romakët për paqtimin e luftës njëqind vjeçare Ilirë-romake, paçka se Roma zyrtare e keqpërdori këtë lëvizje paqësore?!

A nuk ishin arbitri, që së bashku me kryetrimin tonë Gjergj Kastriotin, jo vetë mbrojtën Evropën nga vërshimi otoman, por u shkuan në ndihmë "evropianëve" të Italisë së atëhershme, që rrezikoheshin nga princërit dhe kontët e çakërditur të Mesjetës?!

A nuk ishin shqiptarët, pasardhësit e drejtpërdrejtë të Ilirëve e Arbërve, që ushtarët italianë të viteve dyzet të shekullit të kaluar, ndonëse erdhën me urën e zjarrit në dorë, kur falimentuan, i morën në shtëpi për t'i mbrojtur nga rrebeshi nazist i kohës?!

Të gjitha këto tregojnë se ilirët, arbitri dhe së fundmi shqiptarët, ishin evropianë, ndaj dhe në nivel qytetar, e dinin fort mirë se nuk mund të sillëshin keq me "si vëllezërit e tyre" të kontinentit.

Ndryshon puna me institucionet poli-

tike e shtetërore të Evropës. Ato, as në kohët e lashta, e as në kohët moderne, nuk janë sèkëllidur nga identiteti i përbashkët me shqiptarët, por janë sjellë me këta të fundit si agresorë dhe pushtues.

Për të qëndruar vetëm në 150 vjetëshin e fundit: Duke filluar nga viti 1878 e gjer më sot, Evropa zyrtare, përjashtuar vitin 1999 që u "bashkua" me SHBA-në në mbrojtje të shqiptarëve të Kosovës, në të gjitha rastet e tjera ka vepruar në dëm të trojeve tona. Gjatë gjithë kësaj kohë prej 136 vjetësh, ndërsa shqiptarët i prisnin evropianet me bukë, zyrtarët e kontinentit të përbashkët suleshin me gurë e bajoneta. 1878-ta me Kongresin e Berlinit; 1913 që na ndau me dhunë gjysmën e trojeve; 1915-ta me Traktatin e fshehtë të Londrës që e shuante me gomë çeliku hartën e Shqipërisë; 1939-ta, kur pushtuesit nazifashistë të Evropës zyrtare, na okupuan si dikur otomanët; për të vijuar me gjysme shekulli indiferencë totale, ndaj fatit tonë dhe shenjave, që ne u dhamë në 1960-tën, kur përzumë bazën ruse, e cila kërcënonte gjithë Evropën. Por kjo e fundit, për të mos prishur aleancat e vjetra, qysh të kohës së carëve, nuk i vuri fare ne referent shenjat tona.

E megjithatë, shqiptarët kurrë nuk i njehsuan sjelljet e qarqeve zyrtare, me qytetarët e thjeshtë evropianë, me të cilët kishin jo vetëm afri gjeografike, por dhe rrënjë të përbashkëta në të gjitha fushat e "së ndërtimit të jetës", siç perifrazon profesor Qosja. Mjafton të kujtohet kjo histori dhe të bindemi se identiteti i shqiptarëve është puro evropian. Njollat që mund të jenë krijuar në këtë identitet, nuk mund ta errësojnë atë, ashtu siç nuk mund të errësojnë dritën e diellit njollat që ky lëmsh zjarri ka në trup.

Keqkuptimet (moskuptimet) midis shqiptarëve dhe evropianëve

Keqkuptimet, ose më saktë moskuptimet, kanë zotëruar më shumë tek evropianët për ne shqiptarët dhe jo e kundërta. Po të shikojmë me vëmendje dhe jo për t'i bërë qejfin vetes, ne shqiptarët kemi disa karakteristika e tradita themelore, shumë më të bukura e më të zhvilluara se evropianët. Le të trajtojmë disa prej këtyre ashtu shkarazi:

Cili evropian i kohës së vjetër apo moderne qoftë, do t'i shtronte udhëtarit të rastësishëm darkë dhe shtrat falas, siç bënte Shqiptari i shekullit të 18-të, kur i jepte udhëtarit anglez, francez apo austriak, copën e bukës së fëmijëve dhe shtratin e vetëm të shtëpisë, pa i marrë asnjë kacidhe, edhe kur i huaji i zgjate sterlinat?

Cili evropian i mesjetës e vriste kundërshtarit (hasmin), dhe nuk largohej pa e ndritur viktimën e tij, duke i mbyllë sytë e vënë armën pranë trupit, siç bënte shqiptari?

Në cilin vend të Evropës, përveçse në Shqipëri, nuk u shit për sterlina apo dollarë asnjë hebre, dorëzimi i të cilëve tek

gjermanët do të kishte privilegje, ndërsa e kundërta rrezikonte jetën e familjes?

Nga të rrallët populli shqiptar, i cili nuk ka asnjë rast të luftës civile brenda vendit, dhe asnjë rast sulmi apo gjenocidi kundër fqinjëve. Përkundrazi, edhe pushtuesit që e kanë gjakosur, kur kapitulluan, i mori në shtëpitë e tij e i mbrojti nga rrebeshet e kohës.

Por keqkuptimi më i madh i evropianëve ndaj shqiptarëve lidhet me besimin fetar: Shifra 70 % e myslimanizmit, i vë evropianet në dyshim për identitetin tonë. Mirëpo evropianët, zyrtarë, apo të thjeshtë qofshin, nuk arrijnë të kuptojnë thënien reale të Vaso Pashës se "feja e shqiptarit është shqiptaria". Kjo thënie nuk ka qenë e nuk është slogan propagandë, por një realitet. Ajo është vërtetuar në të gjitha rastet kur rreziku ka kërcënuar kombin dhe vatanin. Nga ana tjetër, le të bëjmë një llogaritje të thjeshtë: Sot, nga 70 përqind myslimanë, një e treta janë bektashinj. Dhe bektashinjët, siç dihet, janë më evropiane se edhe vetë katolikët. Shumica e Rilindësve tanë kanë qenë bektashinj, por veprimtaria e tyre orientohej nga perëndimi. Por në llogarinë e mësipërme duhet të veçojmë dhe ateistët. Dhe në këtë mënyrë myslimanizmi ynë i vërtetë, bie nga mazhoranca. Nga ana tjetër, ne e dimë shumë mirë se, edhe myslimanizmi që mbetet, nuk mund të barazohet me islamizmin e vërtetë.

Identiteti kulturor, bërthama e identitetit të vërtetë

Profesor Kristo Frashëri, në gjykimin e tij për identitetin, na kumton se "identiteti në thelb është shumatore e gjuhës së përditshme, e trashëgimisë historike, e kulturës popullore, e mentalitetit shoqëror, e së drejtës së pashkruar, e mënyrës së jetesës, e aspiratës politike dhe historike, e besimit fetar etj". Të gjitha këto "pjesë" të shumatores, që thotë profesor Frashëri, në shumicë janë në kahun Evropian. Pavarësisht nga mballomat që janë munduar të vënë në këto "pjesë" shekujt me kahe e zhvillime shpesh herë regresiste, ato në thelb kanë mbetur në tabanin e gjenezës sonë të kahershme evropiane.

Në këto vlera, më të dukshmet janë ato kulturore, të cilat janë evidentuar gjithnjë në kahun evropian. Le të cekim disa detaje që vërejmë në jetën e përditshme, detaje të cilat duken si arkaike, por kanë vlerë kulturore të rëndësishme për çështjen që diskutohet. Dihet botërisht se folklori ynë, me shumëllojshmërinë e tij, është ndër më të pasurit e më të bukurit, jo vetëm në rajon, por edhe më tej. Marrja e gjerdanit të artë në vitet shtatëdhjetë në Dizhon të Francës, e vërteton këtë. Ose, le të marrim kostumet tona popullore, në jug, në veri, në lindje apo në perëndim të trojeve tona; kush dominon në ngjyrat e tyre? E bardha dhe e kuqja. Po forma? Pothuaj të gjitha kanë në bazë flatrat e shqiponjës. E shqiponja rritet në Alpe. Dhe Alpet janë

Evropiane. Po kënga? Tingulli i saj nuk ka asnjë ngjashmëri me tingujt që vijnë nga Azia, apo Afrika. Dhe kjo ndodh edhe falë gjuhës tonë shqipe, që ka shkronjat dhe vokacionin e kontinentit evropian.

Shqiptarët, siç argumentojnë mjaft studiues, jo vetëm janë banorët e parë të Evropës, por dhe "aristokratët" e parë të saj. Për të konkretizuar këtë "aristokratët" që shënuam, po japim një detaj: Po marrim kostumin popullor, atë të nuses në krahinën e Mirditës. Një kostum i jashtëzakonshëm për nga bukuria dhe paraqitja, por njëherësh edhe shumë i shtrenjtë nga kostoja. Megjithatë, mirditori, edhe pse ishte më i varfëri qytetar i trojeve shqiptare të shekujt XVII-XX, nuk hezitonte të shiste, gjer dhe "pendën e qeve", me të cilën mbillte tokën, për të blerë e përgatitur kostumin e nuses që do të merrte për djalin. Si shpjegohet kjo sakrificë për një të varfër, që kishte siç thotë Kolë Jakova "Tre pëllëmbë tokë varur përbri / Tre muaj bukë më e mira shpi"? Shpjegimi i thjeshtë është ky: Mirditori, që në lashtësi quhej fisi i Pirustëve, punonte hekurin dhe ishte shumë vite para Evropës në zhvillim. E ai që përpunonte metalin, doemos ishte aristokrat në krahasim me romakun, i cili dinte të përdorte heshtën, por nuk e prodhonte dot përveç bishtit prej druri të saj. Pushtimet e egra të shekujve të mëpasshëm, ia ulën mirditorit (pirustëve, enkelejve, ardianëve, dardanëve, mollosëve e fiseve të tjera ilire) kurrizin ekonomikisht, por nuk ia përkulën e zhdukën dot krenarinë dhe aristokracinë, që e pati fituar më punën e tij paqësore e të zgjuar.

Një detaj tjetër: Kushdo i huaj që ka shkuar në shtëpinë e shqiptarit, ka hasur, jo vetëm në një mikpritje shembullore e tepër bujare, por dhe në një ceremonial pritjeje, që pa frikë, mund ta quajmë të barasvlershëm me pritjet e evropianëve në sallonet mondane. Siç e dimë, në Azi e në Afrikë, ku dominon feja e "qytetërimi" islamik, siç po duan të thonë, pritjet, qerasjet, urimet, përcjelljet e të tjera, bëhen kryesisht duke u përkulur me gjithë trup përpara tjetrit, mikut apo eprorit. Shqiptari, mysliman qoftë katolik apo ortodoks, përveç faljes në xhami, në asnjë rast tjetër nuk përhëndet e uron duke u përkulur përpara tjetrit, por duke "Njatjetuar" me fjalë e me dorën tek balli, ose në zemër. Në çdo shtëpi shqiptari, kur qerasin mikun me kafe, apo raki, marrin edhe vetë filxhanin e kafes e gotën e rakisë dhe shoqërojnë mikun. Dhe kjo, edhe nëse ata e kanë pirë kafën dhjetë minuta para. Kush evropian e bën këtë? Dhe ky, mendojmë se nuk është tradite e veprim "arkaik", "prapanik" apo "anakronik", por një sjellje e kulturuar, një sjellje mondane do të thoshim, që tregon kulturë dhe edukatë të lartë njerëzore e qytetare.

Dikush mendon se qytetërimi vjen vetëm nga arsimit, nga shkolla. Sigurisht arsimit, shkolla, shkenca janë levat krye-

sore, që e çojnë zhvillimin dhe kulturën përpara. Por nuk janë të mjaftueshme. Duhet dhe edukata familjare, e cila trashëgohet brez pas brezi. Jeta e shqiptarit në familje e fise të mëdha, ka ndikuar në transmetimin e traditës më të mirë të krijuar në shekuj, pra dhe të kulturës qytetare, gjë që ka kompensuar në një farë mase edhe mungesën e plotë të arsimit, të shkollës e të dijeve shkencore, në periudhën e mesjetës e gjer në fillim të shekullit të njëzetë.

Kanuni i Lek Dukagjinit, por dhe Kanunet e Kurbinit, të Labërisë, të Malësisë së Madhe e të tjerë, për kohën kur u shkruan e u zbatuan, ishin treguesi më i gjallë e më sinjifikativ i identitetit tonë evropian. Anglezët e Robin Hudit, apo evropianët e Shekullit të 14 e 15, kishin mbret e mbretëri, e megjithatë kacafytëshin me njëri-tjetrin me shtiza e hunj, të nxjerra direkt nga pylli. Ndërsa shqiptarët, edhe në mungesë të plotë të shtetit, kishin rregulla të përcaktuara qartë, me të cilat rregullojnë jetën dhe veprimtarinë e përditshme. Këto rregulla që u përfshinë në Kanunet tona të famshme, studiohen edhe sot nga profesionistët, gjer në Japoni, jo thjeshtë për kureshtje historike, por sepse shumë prej nomeve të tyre, mund të ndihmojnë në formulimin e korpusit të ligjeve moderne të shoqërisë së sotme.

“T’i japim Çezarit atë që i takon Çezarit”!

Kur flitet për identitetin dhe dinjitetin e shqiptarit të Shqipërisë “londineze”, një pjesë e intelektualëve tanë, periudhën gjysme shekullore të socializmit, e quajnë një periudhë, e cila paska dëmtuar, jo vetëm dinjitetin, por edhe identitetin e shqiptarit. Tek periudha e Socializmit, që padrejtësisht e quajnë “komunizëm”, pseudointelektualet tanë “depozitojnë” të gjitha minuset që na pengojnë hyrjen në BE. Po, si qëndron e vërteta?

Historia është e shkruar. Dhe kjo histori ka një të vërtetë të pamohueshme: Asnjë sistem shoqëror i gjertanishëm në Shqipëri dhe, asnjë periudhë historike e dymijë viteve të fundit të ekzistencës sonë si nacionalitet, nuk ka dhënë kontribut më të madh se 45 vitet e periudhës socialiste, në evropianizimin e popullit shqiptar. Të gjitha fushat e jetës dhe veprimtarisë shoqërore kanë pasur në bosht, shikimin nga perëndimi. Ky shikim nuk ka qenë për nostalgji, por i diktuar nga aspirata e shqiptarëve.

Vendi ynë, megjithëse **rrethanat e detyruan të mbështetjës politikisht, ekonomikisht e disa kohë edhe ushtarakisht nga lindja, ai mendjen e kishte nga perëndimi.**

Profesor Frashëri, duke debatuar me mohuesit e vlerave të Socializmit, për “evropianizimin” e shqiptarëve, perifrazon me të drejtë shprehjen e njohur “Jepini Çezarit atë që është e Çezarit”.

Varfëria ekonomike dhe mungesa e shtetit ligjor, dy pengesat për në BE

BE-ja mund të mos na pranojë në gjirin e saj thjeshtë për dy gjëra: Për varfërinë ekonomike dhe për mungesën e një shteti serioz e të konsoliduar. Por kurrësi për mungesën e qytetërimit katolik, me të cilën qenka gatuar Evropa! Këto janë dy arsytet themelore, që e pengojnë vendin tonë të bëhet anëtar e BE-së, e jo besimet e religjionet fetare. Këtu duhet të përqen-

drohet dhe puna e intelektualëve tanë dhe e gjithë shoqërisë. Por që kjo punë të ketë sukses, duhet të analizojmë drejt shkaqet e prapambetjes në këto dy tregues. Po mundohemi të argumentojmë shkaqet në mënyrë telegrafike.

Për varfërinë ekonomike: Disa thonë, dhe përsërisin me të madhe, se varfërinë na e la në derë sistemi socialist. Kjo është një e pavërtetë shumë e madhe. Qysh nga pushtimi romak e gjer më sot, shqiptarët kanë qenë më të varfrit e rajonit, ndonëse kishin dhe kanë pasuritë më të mëdha se çdo vend i këtij rajoni. Pushtimi romak dhe pushtimet e mëvonshme sllave e veçanërisht ai otoman, jo vetëm zhdukën çdo gjurmë zhvillimi e civilizimi të dikurshëm të vendit tonë, por morën masa që populli të mbetej plotësisht në errësirë, sa arriti puna që edhe historinë, shqiptarët e shkruan vetëm me këngë, si dikur Odisea historinë e grekëve të lashtë. E njëjta punë ndodhi edhe në kohët moderne. Shqipëria për fatin e saj të keq, e të mirë, u ndodh

bitën pa mëshirë, duke e katandisur në një vend, ku dhe gjërat më elementare duhet t’i blejë nga kopshti i komshiut.

Akoma më keq ndodhi e po ndodh me shtetin. Dihet historikisht se shqiptari ka pasur alergji për shtetin. Kjo ka ndodhur sepse në shumicën e kohës shteti ka qenë i huaj për të, ka qenë shtet i pushtuesit. Në shtetin e krijuar nga Zogu, shqiptarët morën elementët e parë të shtetformimit. Në 45 vjetët e socializmit shteti shqiptar mori formë të plotë, duke krijuar një administratë sa moderne, aq dhe efikase. Në të dy rastet, por veçanërisht për periudhën e socializmit, thuhet se shteti u ngrit e u mbajt me dhunë! Po, kush mund të thotë se ku është ngritur gjer tani një shtet, që të mbahet pa violencë, pa dhunë? Asnjëri nuk mund ta thotë, sepse kjo nuk ka ndodhur gjer tani në asnjë vend të globit.

Në fillimet të viteve nëntëdhjetë, lidhtarët e “demokracisë” hodhën parullën “Shtet i dobët, individ i fortë”. Kjo gjoja për mbrojtjen e të drejtave të individit nga

gjatësia, aftësia e mundësia e tyre. Dhe që marrëdhëniet midis qytetarëve me diferencën në fizik, në mendje, në mundësi e të tjerë, të jenë korrekte, është e nevojshme që shteti të jetë më i fortë se çdo individ. Shteti fillon e dobësohet, dhe shkon në shuarje, atëherë kur sistemi shoqëror arrin parametrat më të lartë të demokracisë, dhe nuk ka asnjë rrezik që sistemi të kthehet në regres. A i kemi arritur në parametrat e duhura të demokracisë? Jo ne, po as vetë Evropa nuk i ka arritur. Shteti ligjor i evropianëve ka në dispozicion të gjitha mjetet e violencës, për të “disiplinuar” kokrrat e individëve të fuqishëm. Këtë duhet të kemi edhe ne.

Në mbyllje:

BE-ja nuk është përfaqësuese e identitetit evropian, por një institucion politik e shtetëror, që synon të bashkojë në një organizëm të përbashkët interesat politike dhe ekonomike të shteteve, me afërsi gjeografike e zhvillime kulturore e qytetare të përafërta. Në këtë kuptim, nëse BE-ja nuk



në parajsën e Mesdheut (Mesi i Dheut, mesi i “tërveses” së të mirave të natyrës), por edhe në “Udhëkryqin” e rrugëve të Botës. Dhe kur shtëpinë e bukur e ke në udhëkryq, të gjithë kalimtarët ta lakmojnë. Kjo ka ndodhur me shqiptarët gjatë dymijë e kusur viteve. Dhe lakmia e “udhëtarëve”, nuk është mjaftuar me këputjen e një kokrrë në “pemën tonë të begatë”, por me shkuljen nga rrënjët të saj.

Në datën 29 nëntor 1944, kur fillon koha e socializmit, Shqipëria prodhonte vetëm litar kërpi, dhe objekte të artizanatit. Ndërkohë fqinjët, si p.sh. Jugosllavia prodhonte avionin. Për 45 vjet, a mund të barazoheshim ne me fqinjët? Kurrësi, edhe sikur fqinjët të binin në gjumin dimëror të Ariut.

Viti 1990, që shënon fundin e atij sistemi, e gjeti Shqipërinë më një pasuri kapitale jo pak të pafuqishme, por nga që ishte “made-in socialiste”, demokratikisht tanë, së bashku me fqinjët që, “na donin e na duan” shumë, e shkatërruan dhe e gra-

dhuna e shtetit. Sikur të gjithë individët të bëheshin të fortë, kjo do të ishte mrekulli. Por ndodhi që vetëm disa “kokrra” u bënë të fortë, dhe këto kokrra i kërcyen në qafë shtetit, e përmbysën në tokë, duke na lënë fare pa shtet. Tri dekada me vite, dhe shteti i shqiptarëve është jo thjeshtë në spital, por në reanimacion. Kur do të dalë prej andej? “Kokrrat” e individëve të fortë nuk e lënë.

Përgjegjësia për këtë është e politikanëve tanë, por nuk janë pa përgjegjësi dhe zyrtarët evropianë. Dakord, nuk e shihnin dot me sy shtetin socialist dhe e përmbysën. Po çfarë i dhanë shqiptarit? Kausin? Përçarjen? Çoroditjen? Të gjitha ja dhanë. Mund të thuhet se “I zoti e nxjerr gomarin nga balta”. Dakord! Por edhe miku ta jep një dorë për ta nxjerrë. Aq më tepër kur ky “mik” të ka këshilluar, e të ka ndihmuar për ta hedhur gomarin në baltë...

Shteti është administrator e mbrojtës i të gjithë qytetarëve, pavarësisht nga

e pranon Shqipërinë apo shqiptarët, se frikohet nga “besimi mysliman”, atëherë ky bashkim bën dy gabime themelore: Paragjykon padrejtësisht një popull që, në thelb është më evropian se evropianët, dhe së dyti, nxjerr në pah ndjenjën e hershme të nënvleftësismit gjer në injorim, të brezit të Bismarkut, për popujt dhe vendet e vegjël.

Vonesa në pranimin e vendit tonë në BE, nuk është përgjegjësi e shqiptarëve dhe identitetit të tyre, por e politikanëve dhe pushtetarëve që mbahen në pushtet me “yzmin” e vetë BE-s. Shqiptarët e kanë formësuar identitetin evropian, qyshse Kontinenti i tyre ka marrë këtë emër, dhe nuk e kanë ndryshuar asnjëherë, pavarësisht nga dallgët, rrebeshet dhe kryqëzatat që kanë kaluar mbi ta. Është detyrë e intelektualëve, politikanëve dhe veçanërisht e pushtetarëve, që këtë identitet evropian të shqiptarëve, ta zyrtarizojnë në Institucionet e Evropës.

“TAKOJ EMOCIONET”

Emocionet janë themelore, sepse i japin gjallëri, ditë pas dite, jetës sonë. Ato mund ta kushtëzojnë në mënyrë pozitive apo negative humorin tonë, reagues tona me të tjerët, me një fjalë mund të kushtëzojnë lirinë dhe lumturinë tonë. Atëherë, çfarë duhet të bëjmë? Para së gjithash t'i njohim dhe pastaj të mësojmë t'i mbarështojmë ato, pasi nëpërmjet një njohje të saktë të emocioneve dhe të një mbarështimi të vetëdijshëm dhe të pjekur të tyre, mund të jetojmë në harmoni me veten dhe me të tjerët.

“Takoj emocionet” është një rubrikë e cila do të trajtojë pikërisht këto njohje dhe mbarështim të emocioneve njerëzore, me të cilat bëjmë përvojë çdo ditë secili prej nesh

PJESA E GJASHTË

EMOCIONET DREJT ...

TË QENIT MIRE ME VETEN - EUFORIA

Zanafilla e euforisë lidhet me fëmijërinë, në momentin kur fëmija është duke u marrë me detyrën e vështirë të individualizimit të vet dhe, për të parën herë, ndahet nga figura amërore. Kjo ndarje favorizohet nga perceptimi i realitetit të jashtëm si tërheqës: gjithçka është e papritur, e re, objekt eksperimentimi dhe ai hidhet me vrull në detyrën e vështirë të pushtimit të botës. Ndjenja që shoqëron këtë eksplorim të zjarrtë të realitetit është, pikërisht, euforia. Ajo shoqërohet me zell (kjo është arsyeja pse fëmijët nuk lodhen kurrë), të qeshura, ndjenja të vazhdueshme të mirëqenies dhe, shpesh, nga mohimi i çdo kufiri dhe rreziku (për këtë arsye fëmijët hidhen nga shtrati, bien në ujë), pikërisht sepse ai nuk është i vetëdijshëm për brishtësinë e vet dhe për rrezikun që i kanoset atij.

Ky emocion, megjithatë, nuk karakterizon vetëm botën emotive të fëmijës. Ai shoqëron disa momente të jetës, shpesh të shkurtër, ku gjithçka duket se ecën mirë dhe uni, duke u ndier mirë me veten e vet (ndihem në formë), me të tjerët dhe jetën, priret të eliminojë nga vetëdija çdo perceptim të mundshëm negativ të realitetit.

Në fakt, karakteristika e euforisë është mohimi, *i pavetëdijshëm* apo *i vullnetshëm*, i çfarëdo elementi të pakëndshëm që përjetohet. Në rastin e euforisë së pavetëdijshme ndodhemi përpara një emocion zakonisht të papjekur: personi e lë veten të kapet prej asaj që jeton, harron aspektet e tjera të realitetit që, ndoshta, priret t'i eliminojë nga vetëdija, sepse janë shumë të dhimbshme. Edhe më keq, personi mund të përpiqet ta *shkaktojë* këtë emocion, ndoshta nëpërmjet përdorimit të alkoolit apo drogave, me përpjekjen, shpesh jo krejt të vetëdijshme, për t'i ikur një jete që e ndien si të rëndë, shtypëse, pa kuptim. Atëherë ndodhemi përpara ndjenjës së rreme të atij që mendon se mund t'i kontrollojë gjendjet shpirtërore apo të jetë në gjendje të kontrollojë fatin e vet, përfshi edhe emocionet, por herët a vonë do të zbulojë, pas mbarimit të efektit të substancës eksituese se jeta nuk është krejt në duart tona dhe që nuk mjafton të pish ndonjë litër birrë apo raki apo diçka tjetër për të arritur lumturinë.

Ndryshe është euforia e vullnetshme: ajo ofron një moment lumturie që buron nga të ndierit, edhe për një çast të vetëm, që jeta përbëhet nga përvoja të këndshme dhe që gjithçka do të zgjidhet në mënyrë më të mirë të mundshme. Emocion pak i gënjeshtërt, siç janë të gjitha emocionet

kur prirjen të përgjithësojnë një situatë si në të mirë, ashtu edhe në të keq. Por jo për këtë është një emocion i papjekur, pasi nuk ka për qëllim ta mbrojë personin, p.sh. të fshijë gjendje shpirtërore të këqija, por zë fill nga një përvojë e mirë dhe objektive dhe për këtë arsye ky emocion listohet mes emocioneve të konsideruara të pjekura.

Atëherë është e rëndësishme që të kërkojmë të gjejmë shkaqet e euforisë. Nëse lind në mënyrë të vetvetishme, nëse është në *proporcion* me ngjarjen, që e ka shkaktuar dhe nëse nuk mbulon një trishtim, mund të vlerësohet si emocion pozitiv. Shpesh shoqëron etapat e rëndësishme të jetës: një sukses, takim me persona të dashur, takim me dikënd pas shumë kohësh, arritje e diçkaje për të cilën ke luftuar prej kohësh, plotësim i ndonjë dëshire në momentet më të pamenduara, ndonjë ngjarje e mirë që na habit, etj. Në rastet e tjera, përkundrazi, ajo shpesh krijohet nga faktorë të jashtëm, si alkooli dhe droga; apo është fryt i një iluzioni, ashtu si jetohej dallia e nisjes me shpejtësi të madhe të makinës, që na bën të ndihemi zotër të botës dhe na jep sigurinë se gjithmonë mund t'ia dalim pa u lagur. Në këtë rast euforia është e lidhur me një imazh të *shtrembëruar* të vetvetes, në të cilin mbizotëron një perceptim madhështor dhe jo real i unit: një unë i gjithëpushtetshëm, i ngjashëm me atë të fëmijës në fëmijërinë e parë, që nuk e njuh rrezikun dhe ndien se mund të përballojë gjithçka, pa rrezikuar asgjë.

EMOCIONE DREJT...

TË QENIT MIRË ME TË TJERËT - GËZIMI

Gëzimi lind për herë të parë në momentin kur fëmija jo vetëm njih nënën e vet, por kur ajo bëhet e pazëvendësueshme për të, dikush me të cilin ka krijuar një lidhje dhe një lidhje të veçantë, një person që fëmija mund ta dojë dhe të ndihet i dashur prej saj.

Disa elemente që e dallojnë gëzimin janë:

Gëzimi nuk është një qëllim, por gjithmonë një efekt. Nuk mund ta arrijmë gëzimin “duke përdorur” të tjerët, duke i detyruar të na duan apo të na qëndrojnë afër. Ai, në fakt, nuk është një produkt i veprimeve tona, por një *dhuratë*, që buron nga dashuria.

Gëzimi është një emocion që lind në një kontekst marrëdhënor, nga siguria e thellë se jemi qenie të denja për t'u dashur dhe se na duan, nga perceptimi se jeta jonë nuk është thjesht një shumë vitesh, shpesh të rënda, të vështira dhe pa kuptim, por që në të mund të kapim një kuptim, zanafilla e të cilit qëndron në një

dashuri personale ndaj secilit prej nesh.

Prindërit tanë nëpërmjet afektit, ngrohtësisë, përkëdheljeve, butësisë, mbrojtjes, na kanë mundësuar ta tejkalojmë ndjenjën e kërcënimit fillestar, që na bënte ta ndienim veten të vegjël, të brishtë, të prekshëm dhe të humbur në një botë tepër të madhe dhe të rrezikshme. Dashuria e tyre na ka ndihmuar t'i tejkalojmë vështirësitë dhe të besojmë te dashuria dhe kjo na ka mbushur me gëzim.

Më pas kemi zbuluar gëzimin e miqësisë, të lindur nga afërsia dhe nga simpatia ndaj dikujt që mendon dhe ndien gati si ne; atë të dashurimit dehës, në të cilën jetohej zbulimi entuziazmes se ai i do të tjerët dhe prej tyre duhet në mënyrë të vetme dhe ekskluzive; gëzimin e qetë dhe të shtruar të dashurive familjare.

Gëzimi, fryt i dashurisë së marrë, buron edhe prej asaj që dhurohet. Besimi dhe siguria e të qenit të dashur prej tjetrit, në fakt, përbën sfondin e afekteve më domethënëse, duke krijuar një klimë sigurie që sjell me vete dëshirën për t'u dhuruar dhe gëzimin që rrjedh prej kësaj klime. Ai që e di se e duan i kapërcen konfliktet, nuk humb në dredhat e errëta të frikave dhe të xhelozive të veta, përpiqet t'i kuptojë këndvështrimet e tjetrit dhe sidomos *gëzon prej faktit se ia do të mirën tjetrit*. Kështu lind nevoja këmbëngulëse për t'u dhuruar, për ta parë tjetrin të lumtur, për të plotësuar dëshirat e tij, për të bashkëpunuar me të për realizimin e qëllimeve të tij.

Gëzimi i vërtetë duke qenë se lind nga dhurimi nuk e kërkon medoemos praninë e objektit të dashur, edhe pse e dëshiron atë vazhdimisht. Ajo që vlen më shumë për të dhe që më së shumti dëshiron është e mira e tjetrit, lumturia e tij. Kjo dëshirë krijon një bashkësi të thellë, edhe pse të një lloji tjetër. Kështu personat që duam mund të banojnë në ne, të lëshojnë rrënjë në zemrën tonë. Kjo ruajtje e tjetrit në brendësinë tonë na vë në një atmosferë gëzimi dhe paqeje, edhe pse në vështirësi, në luftrat e përditshme kundër egoizmit tonë, që na shtyn të zotërojmë, të mbajmë për vete, të fitojmë dashurinë e tjetrit.

Pra, gëzimi është sfondi dhe atmosfera në të cilin lind dhe rritet dashuria: ajo që na japin dhe ajo që u japim të tjerëve. Megjithatë nuk është i vetmi emocion që shoqëron dashurisë.

EMOCIONE DREJT...

EMOCIONET E AFËRSISË

1. DHEMBSHURIA

Dhembshuria lind nga perceptimi i *cenueshmërisë* dhe *i brishtësisë* së tjetrit. Si rrjedhojë, na ngjallin dhembshuri personat e dobët, të pambrojtur apo që bëhen të tillë duke vendosur të mos maskohen apo të fshihen dhe që, falë paraqitjes së tyre të paarmatosur, ngjallin në ne dëshirën për t'i mbrojtur, për t'u kujdesur për ta.

2. SOLIDARITETI

Ndërsa dhembshuria i drejtohet në përgjithësi një personi të vetëm, dobësia e të cilit na tërheq dhe na përfshin emocionalisht, solidariteti përfshin shumë individë. Konkretizohet në një angazhim, veprim, vendim, marrje përgjegjësish, por lind nga një emocion. Ajo që e ngjall këtë emocion është një intuitë e thellë e situatës së vështirësisë në të cilën gjenden të tjerët, prej nga lind edhe dëshira për t'u

angazhuar dhe për të punuar për të mirën e tyre.

3. MIRËNJOHJA

Ndërsa simpatia dhe të gjitha ndjenjat që karakterizojnë dashurimin, të shtyjnë jashtë vetes për të shkuar drejt tjetrit, mirënjohja shpreh një qëndrim më mikpritës të personit ndaj tjetrit. Lind nga perceptimi i paplotësisë dhe i varfërisë vetjake, por në vend që të vërë në dukje mungesën siç ndodh në rastin e trishtimit, vë në dukje bujarinë e tjetrit, që përpiqet ta mbushë këtë boshllëk.

Ajo që e dallon mirënjohjen nga dëshpërimi nuk është vetëm një situatë më e vogël mungese, por mënyra e shikimit të realitetit. Ndërsa në rastin e dëshpërimit shikimi është i përqendruar mbi veten time, vështirësitë e tensionet e të cilit absolutizohen, në rastin e mirënjohjes vëmendja përqendrohet jashtë vetes, te dhuruesi dhe te bujaria e tij.

4. SIMPATIA

Simpatia lind nga një ndjesi instinktive, e menjëhershme, një *feeling*, që krijon një tërheqje të çastit për një person, sepse kemi dalluar te tjetri diçka që na pëlqen, që na tërheq. Shpesh është subjekt gabimesh: dëshira për të gjetur në ata që na rrethojnë një element që na bashkon, na shtyn të shohim te tjetri atë që në fakt ai nuk e ka, por që, prej dëshirës sonë për ta pasur, ia kemi veshur.

Nga ana tjetër simpatia vë bazat për të krijuar marrëdhënie të thella, afërsie, afekti dhe miqësi. Sidomos kjo e fundit, në fakt, lind dhe shprehet si zbulim i një përputhjeje të thellë, shpesh të lindur nga një ndjenjë e menjëhershme, si simpatia, që thellohet dhe zgjerohet gjithnjë e më shumë, duke gjetur motive më objektive dhe racionale, këndvështrime dhe pasione të përbashkëta, të afta për të krijuar dëshirën për të komunikuar dhe për të bashkëndarë.

5. TËRHEQJA

Nëse simpatia dhe mirënjohja karakterizojnë marrëdhëniet e përzemërsisë dhe të miqësisë, më totalizuese janë emocionet e lidhura me dashurimin dhe dashurinë bashkëshortore. Dikush e ka përcaktuar si “*diçka që të kap nga brenda dhe nuk kupton më asgjë*”. Siç e thotë edhe vetë termi, i përgjigjet një të ndieri të tërhequr, të shtyrë drejt atij/asaj që na pëlqen. Shpesh shprehet në nivel seksual, por, kur shoqëron dashurinë e vërtetë i referohet tërësisë së personit. Vë në dukje një person të tërhequr nga nuri i tjetrit, një përfshirje totale.

Tërheqja përshkruan të qenit i tërhequr si me magnet nga tjetri, që shprehet me nevojën për t'i qëndruar afër, për të gëzuar prej pranisë së tij, për t'iu referuar vazhdimisht asaj që ai jeton, mendon, ndien. Sidomos nëse nuk kufizohet në dimensionin seksual, ajo zakonisht shoqërohet nga një ndjenjë edhe më intensive: pasionin¹.

6. PASIONI

Me këtë term i referohemi pjesërisht *dashurisë erotike*, të kuptuar jo si dashuri seksuale, por si ndjenjë tipike e të dashuarve.

Një person që është i dashuruar nuk është në gjendje të mendojë për seksin, sepse është shumë i zënë duke menduar për personin. Nëse do ta pyesnim këtë person se çfarë dëshiron, përgjigja e tij

¹ Termi pasion vjen nga latinishtja *passio* domethënë vuaj, mundohem.

Kisha e Thethit



Bjeshkatarë dhe vizitorë të rastit, midis të cilëve edhe Ernest Koliqi, në Buni të Balbonës, në Rragam të Shalës, 1938.



Ura e Shalës, 1938.

Në shtëpinë e Nikë Gjonit, Nicaj-Shosh 1938



REDAKSIA

Kryeredaktore: LUIGJ SHYTI

Redaktorë: Suela Ndoja, Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja, Kole Çardaku, Eilda Delija, Age Martini, Klodiana Serraj, Vilson Peshkaj, Marijan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza e Ndue Ziçi.

Mundësoi Botimin:

GJERGJ LEQEJZA

